



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në
“Inxhinieri Materiale”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Egla LUCA
2. Dr. Erion LUGA

Egla Luca
Erion Luga

Janar/ 2023

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al

Faqe 1

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Materiale” ofruar nga
Insitucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Politeknik i Tiranës


Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Prodhim Menaxhimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Inxhinieri Materiale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH Nr. 1583/1 Prot, datë 12.05.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 180, datë 16.04.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite / 6 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	32 PAE/ 3 PAK v.a. 2018-2019 32 PAE/ 3 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	63 v.a. 2019-2020 55 v.a. 2020-2021 51 v.a. 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423
web site:www.ascal.al

Faqe 2



PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Materiale ofruar nga Univeristeti Politeknik i Tiranës është pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Prodhim Menaxhimit. Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me qëllimin e objektivat e tij dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare të zhvillimit të arsimit të lartë dhe të tregut të punës. Ky program studimi:


- Ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2005
- Zgjat 3 vite akademike, realizohen 180 kredite, gjuha e zhvillimit të programit të studimit është shqip.

Ky program studimi është hartuar në përputhje dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, të kohës. Plani mësimor është i organizuar në lëndë semestrare, të cilat vlerësohen me kredite sipas sistemit ECTS. Programi studimit synon gjithashtu t'u japë studentëve një përgatitje me spektër të gjerë, veçanërisht në fushën e Inxhinierisë Materiale.

Ecuria e këtij programi në vite ka treguar qëndrueshmëri, gjë që tregohet dhe në numrin e studentëve që pranohen çdo vit, mesatarisht 50-70 studentë/vit. Niveli i lartë i kualifikimit të stafit akademik që angazhohet në këtë program studimi është një garanci më shumë për vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij. Pjesa më madhe e mësimdhënies mbulohet nga stafi akademik efektiv, dhe vetëm 2 staf akademik me kontratë angazhohen në këtë program studimi.

UPT ka garantuar për studentët një infrastrukturë bashkëkohore (auditorë, laboratorë, biblioteka, zyra etj) por jo të mjaftueshme për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi. Struktura akademike dhe ndihmës akademike mbështet studentët dhe stafin akademik në përparimin e tyre. Kjo strukturë përmes akteve të brendshme rregullatore, garanton barazi dhe transparencë të proceseve brenda UPT. Gjithashtu, studentët përfshihen në vendimmarrjen e UPT në të gjitha nivelet dhe sistematikisht iu merret mendim në lidhje me cilësinë e mësimdhënies në UPT.

Nga UPT është në vëmendje mbështetja e studentëve edhe pas diplomimit, përmes rrjetit Alumni dhe bashkëpunimeve të shumta që ka me biznese e subjekte shtetërore e private të fushës së inxhinierisë dhe jo vetëm.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) është ngritur nga ASCAL mbështetur në kërkesën e Universitetit Politeknik të Tiranës, regjistruar në protokollin e ASCAL. GVJ përbëhet nga dy anëtarë: Dr. Egla Luca dhe Dr. Erion Luga, ku Koordinator teknik për ASCAL në këtë procedurë vlerësimi është MSc. Juna Mengri.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë përzgjedhur duke patur në konsideratë kompetencat profesionale në lidhje me fushën e këtij programi studimi, eksperiencën e tyre në vlerësime të programeve të studimit, integriteti profesional, mungesa e konfliktit të interesit për të siguruar paanshmëri dhe objektivitet në gjykim dhe në vlerësim.

GVJ, në punën e tij, ka shfrytëzuar “Raportin e vlerësimit të brendshëm” të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), i ngritur pranë Departamenti i Prodhim Menaxhimit, si dhe dokumentacionin në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) që shoqëronte këtë raport. Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësish të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Të dhënat e vëna në dispozicion përmes DVV u diskutuan dhe u verifikuan gjatë takimeve vlerësuese të zhvilluara 05 Korrik 2022, në kujdesin e koordinatorit teknik të ASCAL. Institucioni kishte marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të takimeve, në përputhje me agjendën e vizitës.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur dhe diskutuar gjatë takimeve me përfaqësuesit e Institucionit.

Më datë 22/11/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 186/37 Prot., datë 22/11/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

UT kthehu përgjigje, përmes AMS, më datë 13/12/2022.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:

Standardi 1.5 Kriteri 3 - Rekomandimi qëndron pasi në asnjë prej anekseve nuk detajohet “lesson learned” mësimet e fituara apo eksperiencat e mara nga secila prej marrëveshjeve të bashkëpunimit

Standardi 2.4 Kriteri 5 - GVJ ka dhënë një konstatim mbi gjëndjen faktike të praktikave profesionale. Konstatimi qëndron

Standardi 3.1 Kriteri 2 - Rekomandimi qëndron pasi vlerësimi i stafit akademik nga studentët ishte një çështje mjaft e diskutuar gjatë takimit me studentët. Ata u shprehën që në disa raste nuk janë ndjerë të lirshëm të shprehin mendimin e tyre. Ky rekomandim është mjaft i rëndësishëm të ndiqet.

Standardi 3.1 Kriteri 4 - Rekomandimi qëndron pasi gjatë takimit me studentët na u tha që për një profesor bëjnë vetëm një vlerësim, edhe nëse profesori jep më shumë se një lëndë.

Standardi 3.6 Kriteri 2 - Rekomandimi qëndron pasi edhe vetë IAL është shprehur që sistemi elektronik i testimit dhe vlerësimit mungon për këtë program studimi.

Standardi 3.6 Kriteri 8 - Rekomandimi qëndron pasi edhe gjatë takimit me stafin akademik u shpreh që studentët nuk nxiten të ankimojnë nota. Gjatë takimit me studentët na u shpreh ndjenja e hezitimit për të ankimuar nota

Standardi 3.8 Kriteri 5 - GVJ ka shprehur në raport atë cka studentët shprehën gjatë takimit. Rekomandimi qëndron

Standardi 3.8 Kriteri 6 - GVJ pranon komentin e IAL dhe përditëson raportin

Standardi 3.8 Kriteri 10 - Rekomandimi qëndron

Standardi 4.4 Kriteri 4 - Rekomandimi qëndron, pasi GVJ i referohet gjëndjes aktuale të bibliotekave.

Standardi 4.4 Kriteri 6 – Ashtu si në Standardi 4.4 Kriteri 4, Rekomandimi qëndron. Gjithashtu edhe studentët e shprehën disa herë qartazi që nuk kanë informacion në lidhje me bibliotekat.

Standardi 5.3 Kriteri 4 – Për të njëjtat arsye si më lart Rekomandimi qëndron.

Standardi 5.3 Kriteri 5 – Rekomandimi qëndron.

Standardi 5.4 Kriteri 4 – Rekomandimi qëndron, sepse plotësimi i regjistrave në mënyrë të rregullt është kusht, pavarësisht sistemit digjital që IAL mund të përdorë.

Standardi 5.5 Kriteri 4 – Rekomandimi qëndron

Standardi 5.5 Kriteri 5 – Bazuar në argumentet e dhënë në RVJ, Rekomandimi qëndron.

Standardi 6.1 Kriteri 2 – Si dhe pohohet nga GVB, Rekomandimi qëndron.

Standardi 6.1 Kriteri 4 – Ashtu si më lart, Rekomandimi qëndron.

Standardi 6.2 Kriteri 2 – Pavarësisht argumenteve të GVB, sipas GVJ moskryerja e asnjë ndryshimi në kurrikul për një periudhë 17 vjecare tregon që kurrikula nuk ka reflektuar zhvillimet teknologjike të kësaj periudhe. Rekomandimi qëndron.

Standardi 6.3 Kriteri 3 – GVB nuk ka paraqitur argument, Rekomandimi qëndron.

Standardi 6.4 Kriteri 4 – Bazuar në cka është shprehur në RVJ, GVJ mendon se ky aspekt duhet ndjekur me shumë kujdes nga IAL, Rekomandimi qëndron.

Standardi 6.4 Kriteri 5 – Bazuar në cka është shprehur në RVJ dhe në mungesën e reflektimit të zhvillimeve teknologjike në ndryshime të kurrikulës GVJ shprehet se Rekomandimi qëndron.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Materiale”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nëpërmjet konsultimit me dokumentacionin bazë të dosjes së vetëvlerësimit (DVV) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion (Minutat e takimeve), GVJ konkludon që programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale" ofron një kurrikulë mësimore konkurruese, programe lëndësh të përditësuara e me nivel pedagogjik e shkencor të mirëasimilueshëm, infrastrukturë e logjistike të përshtatshme dhe cilësi produkti të kërkuar në tregun e punës dhe të mirëpritur nga nivelet e tjera të studimit profesional. Cilësia e këtij produkti dhe angazhimi i tij në përdorimin e njohurive të fituara është në përputhje të plotë me interesin kombëtar. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Materiale” është konceptuar në përputhje me vizionin e UPT, sipas të cilit arsimit i lartë ka një rol parësor e unik në përmirësimin e kohezionit social të një vendi. <i>Referencë: DVV (aneksi 000; 001; 002; 011; 008; 009; 010)</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit (PS) Bachelor në “Inxhinieri Materiale” ka funksionuar si i tillë qysh nga viti 1974 (Inxhinieri Metalurgjie). Ne vitin 2005, pas ristrukturimit në sistemin 3+2, programi u riemërtua ne Inxhinieri Materiale. Produkti i tij tashmë ka identitet të qartë dhe është integruar plotësisht në komunitetin e profesionistëve të fushës së materialeve. Si i tillë, referuar RVB dhe planeve strategjike të Universitetit, ai ka dëshmuar se është në vazhden e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e shkencore te degës së origjinës dhe UPT <i>Referencë: DVV (aneksi 000; 001; 002; 010)</i>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konsultoi jo vetëm kurrikulën aktuale dhe syllabuset e lëndëve, por edhe planet strategjike të institucionit dhe njësisë bazë. U gjet që ky PS është konkurrenës në kuadrin kombëtar dhe ka ambicien të mbetet i tillë në fushën e Inxhinierisë së materialeve. Në këtë perspektivë duket qartë që ky PS zhvillohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. <i>Referencë: DVV (aneksi 000; 001; 002; 007; 008; 009; 010; 011; 024; 040; 039; 023)</i>
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje	Referuar kurrikulës së këtij programi studimi, konstatohet që ajo është hartuar e tillë që të nxjerrë produkt sa më cilësor, ndërsa referuar

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423
web site:www.ascal.al

Faqe 6

dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	angazhimit të produktit të këtij PS konstatohet, që ai ka kompetencën e duhur për të nxitur zhvillimin ekonomik kudo ku ai angazhohet, si pershembull industri prodhimi materialesh, akademi (kerkim shkencor). <i>Referencë: DVV (aneksi 000; 001; 002; 010; 011; 024; 040; 039; 023)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Referuar planit strategjik të UPT, për periudhën 2019 - 2024, lidhur me vizionin, prioritetet dhe objektivat strategjike, si edhe planin strategjik të fakultetit (FIM), GVJ konstaton që PS Bachelor në "Inxhnieri Materiale" ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit. Ne planin strategjik të FIM cilesohet (Pika 1.2 Misioni) " <i>Ofrimi i studimeve në të tre ciklet e studimit në fushat e inxhinierisë mekanike, inxhinierisë së materialeve dhe të inxhinierisë tekstile dhe modës dhe inxhinierisë ekonomike; Kërkimi shkencor në fushat e teknologjisë mekanike, energjetikes, transportit, shkencës së materialeve, inxhinierisë tekstile, menaxhimit të sipërmarrjeve industriale; Ofrimi i shërbimeve për industrinë në formën e studimeve, ekspertizave, kontrollit të cilësisë dhe konformitetit të produkteve industriale;</i> ". Po ashtu në misionin e UPT, përfshihen të gjitha strategjitë e FIM dhe programit të studimit. <i>Referencë: Planit strategjik UPT dhe FIM (anex 002 ; 004; 006; 010; 007)</i>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	GVJ konsultoi paraprakisht statutin e institucionit, rregulloren e tij, si edhe rregulloren e njësisë bazë për programin e studimit (PS) Bachelor në "Inxhnieri Materiale". Zbatimi i përcaktimeve statutores dhe rregullore të institucionit konstatohet edhe në standartizmin e mënyrës së hartimit të dokumentacionit të njësisë bazë. Programi i studimit është në linjë me statusin dhe rregulloren e UPT, me specifikisht në Nenin 55 thuhet Programet e ciklit të parë të studimeve: 1. Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180

	<p>kredite evropiane (ECTS). Kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike dhe në përfundim lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer.</p> <p>2. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Në rregulloret e programeve të studimit të ciklit të parë përcaktohen mënyra e diplomimit, kriteret dhe procedura e diplomimit.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi 001; 002; 004; 006; 007; 015; 009; 008; 010)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Universitetit Politeknik i Tiranës u krijua në vitin 1991, si vazhdim i Institutit të Lartë Politeknik në Tiranë, i cili përmbante 3 degë inxhinierike: Degen e Inxhinierise Mekanike, Degen e Inxhinierise Elektrike dhe Degen e Inxhinierise së Ndertimit. Fakulteti i Inxhinierise Mekanike është një nga 4 fakultetet themelues të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT). Në Fakultetin e Inxhinierise Mekanike, është përfshirë edhe formimi universitar në fushën e Materialeve, që ka një histori të gjatë zhvillimi prej vitit 1969 me ngritjen e Katedrës së Metalurgjisë dhe njekohesisht të degës së studimeve për Inxhinieri Metalurgjike. Të diplomuarit e parë, Inxhinieri Metalurg, i perkasin vitit 1974. Në këtë kuadër GVJ, referuar dokumentave të DVV-së, konstaton që PS Bachelor në "Inxhinieri Materiale", i cili ofrohet nga Departamenti i Prodhim Menaxhimit, si njësi bazë, dhe Fakulteti Inxhinierisë Mekanike, si njësi kryesore, është në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të Universitetit Politeknik të Tiranës. <i>Referencë: DVV (aneksi 000; 001; 002; 007; 005; 015)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Referuar RVB-së si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra në të gjitha lëndët e kurrikulës, duke nxitur pasionin për t'i thelluar njohuritë në ciklet e tjera të studimeve, duke formuar koncepte të qarta për dobësi e punës në ekip, duke rritur përgjegjësinë në vlerësimin e rezultateve të analizave laboratorike, duke njohur</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al

Faqe 8

	<p>konkurrencën në tregun e punës, dhe duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe dobinë e produkteve të tyre. Referuar objektivave të përcaktuara si koncepte themelore në syllabysset e lëndëve, kostatohet që në këtë PS synohet t'u jepen studentëve dije, aftësi dhe kompetenca profesionale që karakterizojnë profilin e tij si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. aftësi për të zbatuar njohuri të matematikës, disiplinave shkencore dhe inxhinierike; 2. aftësi për të hartuar një sistem përbërës ose proces në përmbushje të nevojave të dëshiruara; 3. aftësi për të funksionuar në ekipe multidisiplinare ; 4. aftësi për të identifikuar, formuluar dhe zgjidhur probleme inxhinierike; 5. përceptim të përgjegjësisë profesionale dhe etike; 6. aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive; 7. edukim për të kuptuar ndikimin e zgjidhjeve inxhinierike në një kontekst global dhe shoqëror; 8. njohje të nevojës dhe disponim të aftësisë për t'u përfshirë në mësimnxënie përgjatë gjithë jetës; 9. përditësim të njohurive bashkëkohore; 10. aftësi për të përdorur teknikat dhe mjetet moderne inxhinierike të nevojshme për punën si inxhinierë materialesh etj. <p><i>Referencë: Dokumentet e DVV (RVB; aneksi 023)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ konstatoi që institucioni kryen studime për tregun e punës. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme të fushës së materialeve e rrotull saj. Këto marrëveshje janë një bazë e mirë për punësimin e ardhshëm të të diplomuarve. Gjithashtu në kuadër të marrëveshjeve, referuar dokumentit 066, UPT ka kryer një numër të konsiderueshëm mobilitetesh stafi dhe studentësh. Gjatë vizites në institucion, na u theksua që PS ka funksionuar prej shumë vitesh në bashkëpunim me një IAL Gjermane, dhe tani po vazhdon bashkëpunimin me IAL franceze. Marrëveshjet jetësohen edhe nëpërmjet rrejtit alumni i cili mundëson shtimin e numrit të bashkëpunimeve</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi 004; 031; 049; 066; 051; 032; 110)</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në aspektin formues objektivat e PS Bachelor në "Inxhinieri Materiale" synojnë t'u sigurojnë studentëve dhe të diplomuarve dije profesionale, zotësi në përdorimin e tyre, kuptim dhe zgjidhje të problemeve në prodhimin dhe implementimin të shumë materialeve, dëshirë dhe ambicje për të njohur e përvetësuar informacionin bashkëkohor etj. Realizimin e këtyre objektivave GVJ e konstaton të arriturë bazuar në informacionet që siguroi për produktin e deritanishëm, si dhe duke analizuar kurrikulën ekzistuese, syllabuset e lëndëve të veçanta, në kategorizimin e tyre A, B, C, D dhe E, duke shqyrtuar planet strategjike të zhvillimit si</p>

	dhe duke parë angazhimin konkret si të personelit akademik e ndihmës ashtu edhe të studentëve. <i>Referencë: DVV (aneksi 010; 023; 024; 011; 081)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua gjetjeve në RVB si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion. Nisur nga këto, GVJ konstaton që Institucioni i ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale". Në RVB burimet përvoja dhe kapacitetet e UPT paraqiten si më poshtë:</p> <p>Burimet Infrastrukturore: Mjedise për studentët (auditorë, klasa për leksione dhe seminare, laboratorpër kryerjen e disa provave, laboratorë informatike, bibliotekë, mjedise për fotokopjim/librari, zyra për informimin e studentëve, mjedise sociale dhe sportive); Mjedise për stafin⁴ (zyra, sallat e mbledhjeve, mjedise për personelin e shërbimit, mjedise çlodhëse).</p> <p>Shërbime IT</p> <p>Burimet njerëzore: Numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik, me një përvojë të përshtatshme në disiplinat specifike të inxhinierisë së ndërtimit.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti Inxhinierisë Mekanike. Në strukturën përbërëse të tij përfshihet edhe Departamenti i Prodhim Menaxhimit (përgjegjës për programin e studimit).</p> <p>Per vitin akademik 2019-2020 Tabela 7: Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe ai efektiv për programin e studimit (32 pedagogë PAE dhe 3 PAK) përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 4 Profesorë Dr. PAE dhe 0 PAK - 5 Profesorë të Asociuar Dr. PAE dhe 0 PAK - 19 Doktorë/PhD PAE dhe 1 PAK - 3 MSc. PAE dhe 2 PAK <p>Per vitin akademik 2018-2019 Tabela 7</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe ai efektiv për programin e studimit (32 pedagogë PAE dhe 3 PAK) përbëhet nga:</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al

	<ul style="list-style-type: none"> - 4 Profesorë Dr. PAE dhe 0 PAK - 5 Profesorë të Asociuar Dr. PAE dhe 0 PAK - 19 Doktorë/PhD PAE dhe 1 PAK - 3 MSc. PAE dhe 2 PAK <p>Po te njëjtat shifra janë për vitin akademik 2017- 2018</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton ekzistencën dhe përdorimin me efektivitet si të përvojës ashtu edhe burimeve e kapaciteteve.</p> <p><i>Gjate vizites ne IAL u kerkua plotesimi i anekseve te dorezuara, perfshire edhe numrin e stafit akademik per vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022. Ky informacion nuk u vu ne dispozicion per shqyrtim. IAL nuk vuri ne dispozicion tabelat per stafin akademik te Dep apo dhe pergjegjes te programit te studimit per v.a. 2020-2021 dhe 2021-2022.</i></p> <p><i>Referencë: DVV (RVB tabela përmbledhëse nr 7; aneksi 072; 075; 054; 034;</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Inxhnieri Materiale” është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, si edhe të Departamentit të Prodhim Menaxhim. Është kryer kodifikimi i lëndëve siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Referencë: DVV (RVB; 006)</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri GVJ iu referua gjetjes në RVB ku shkruhet se programi i studimit Bachelor në “Inxhnieri Materiale” ofrohet nga Departamenti i Prodhim Menaxhimit, i cili, sipas ligjit të arsimit të lartë, është njësi bazë e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike. Departamenti ka të drejtë të japë grada universitare, duke ofruar trajnime akademike për studentët dhe promovon kërkime shkencore në nivelin më të lartë. Departamenti ofron programe studimi në nivelin Bachelor dhe Master. Departamenti mirëpret studentët që dëshirojnë të studiojnë për programet e studimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit të arsimit të lartë në Shqipëri, si dhe me procesin Evropian të Bolonjës dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Inxhnieri Materiale” është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të Departamentit të Prodhim Menaxhim. Në planin strategjik të këtij departamenti GVJ gjeti objektivat dhe synimet e departamentit lidhur me zhvillimin e PS Bachelor në “Inxhnieri Materiale”. Është kryer kodifikimi i lëndëve siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të</p>

	Iartë në Republikën e Shqipërisë". Referencë: DVV (RVB; 006; 008; 009)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB, si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton se në Universitetin Politeknik të Tiranës ka marrëdhënie bashkëpunimi funksionale midis të gjitha njësive kryesore e ato bazë brenda institucionit. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Prodhim Menaxhimit, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore (fakultetet). Në rastin konkret GVJ u informua për një sërë aktiviteteve me pjesëmarrje të studentëve e pedagogëve. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. GVJ konstatoi shkresa zyrtare dhe marrëveshje të shkruara që rregullojnë bashkëveprimin e brendshëm midis njësive bazë dhe atyre kryesore në UPT.</p> <p>Referencë: Dokumentetet e DVV; Protokollit i takimeve gjatë vizitës në Institucion; anex 004; 048; 005; 104; 082)</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Përveç gjetjeve në DVV, lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe, brenda e jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit, vendas e të huaj, në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e zyrës së projekteve e marrëdhënieve ndërkombëtare, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet, duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme.</p> <p>Aktualisht UPT ka 34 marrëveshje aktive bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus +. Në kuadër të programit të studimit janë aktive shumë marrëveshje me biznese të ndryshme si EVEREST, ALUMIL, ELBA LAB, etj. IAL po punon për realizimin e një programi të dyfishtë studimi me Universitetin e Tuscia në Itali</p> <p>Referencë: DVV (annex 049), Minutat e takimeve gjatë vizitës në Institucion</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423
web site:www.ascal.al

Faqe 12


<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ mësoi se në çdo fundviti akademik praktikat vlerësohen nga një komision i posaçëm dhe nga vetë studentët me anë të një formulari, nga i cili merret një informacion në lidhje me efektshmërinë e realizimit të praktikave. Institucioni nuk harton një raport të dedikuar analitik për përfitim nga marrëveshjet e bashkëpunimit por këto ceshtje diskutohen në asamblenë e personelit akademik. <i>GVJ rekomandon që institucioni çdo fund viti të hartojë një raport për përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale"; Referencë: DVV (aneksi 049; 050)</i></p>
--	---

<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Bazuar në DVV, GVJ mësoi se bashkëpunimi me punëdhënësit, për kryerjen e praktikave profesionale është vendosur përmes marrëveshjeve të shkruara, por jo detyruese. UPT ka rreth të tilla ma kompani dhe institucione. Një rol të rëndësishëm në realizimin e praktikës ka edhe pedagogu përgjegjës i cili është personi përgjegjës i caktuar nga Drejtuesi i Departamentit dhe Koordinator i programit të studimit për të drejtuar, mbikëqyrur dhe vlerësuar aktivitetin e studentit gjatë praktikës profesionale. <i>Referencë: DVV (aneksi 049; 031; 051; 052; 053)</i></p>
--	---

<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në bisedat e kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se UPT organizon trainime profesionale për studentët, kryesisht në formën e leksioneve të hapura, gjatë të cilëve specialistë të huaj dhe vendas sjellin përvojën e tyre për stafin. FIM ka 3 kurse të formimit të vazhduar, departamenti i prodhim menaxhim ofron kursin e formimit të vazhduar në " Vlerësim i linjave teknologjike makinerive dhe pajisjeve". Lidhur me programin e studimit, vlen të theksohet ftesat që IAL ju bën kompanive të ndryshme të vijnë dhe të prezantojnë produktet dhe teknologjitë e tyre. Gjatë vizitës në IAL na u tha që EVEREST ka sjellë përfaqësuesit e tyre për të zhvilluar leksion të hapur. <i>Referencë: DVV (aneksi 039), protokollin e takimeve gjatë vizitës në Institucion</i></p>
---	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale" është i strukturuar në 3 vite akademike dhe 6 semestra të rregullt. Zhvillohen gjithsej 37 lëndë të ndara sipas 3 viteve (13 lëndë në vitin e parë; 12 lëndë në vitin e dytë; 12 lëndë në vitin e tretë). Në 37 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës, si edhe praktika profesionale. Lëndë të detyrueshme janë 35. Lëndë me zgjedhje janë 2. Organizimi i PS Bachelor në Inxhinieri Materiale bëhet në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në fuqi. Organizimi i PS Bachelor në Inxhinieri Materiale bëhet në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në fuqi. Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores së programit të studimit vërehet që programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/ detyra, veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Referencë: DVV (Tabela 7 në tabelat përmbledhëse; aneksi 010; 011; 023)</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale siguron formimin e shprehive të veçanta në një gamë të gjere specialitetesh të përshtatshme për ambiente të ndryshme pune në analizë, prodhim dhe menaxhim të materialeve të ndryshme, të shërbimeve për kontrollin e materialeve si dhe testimin e tyre në sektorë të ndryshëm industrial. Punëdhënësit e ardhshëm përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në kompanitë prodhuese të materialeve, firmat</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

	<p>këshilluese, firmat industriale, agjensitë e ndryshme qeveritare, etj. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi 049; 031; 051; 052; 053; 010)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Lëndët e parashikuara të zhvillohen në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale janë të larmishme. Fillohet me analizë matematikë 1 dhe 2, fizikë 1 dhe 2, kimi e aplikuar dhe organike, mekanika, vizatim teknik dhe CAD; Më tej vazhdohet me lëndë të dedikuara të profesionit si Shkenca dhe teknologjia e materialeve, Metalurgji etj. Programet lëndore (syllabuset) të hartuara synojnë të rrisin aftësinë e studentëve të kuptojnë parimet e inxhinierisë së materialeve. Si pasojë programi ofron njohuri të përparuar, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. <i>Referencë: DVV (aneksi 023;011)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të përpashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Duke iu referuar kurrikulës së PS Bachelor në "Inxhinieri Materiale", vërehet që krahas lëndëve të përgjithshme dhe atyre praktike në planin mësimor janë parashikuar të zhvillohen edhe lëndë që ofrojnë njohuri të thelluara dhe të përparuar në fusha akademike apo profesionale. Përfshihen këtu lëndë të zhvilluara kryesisht në vitin e tretë dhe që lidhen me materiale polimere, materiale kompozite, metalurgji dhe saldim, qeramik; fonderi; etj</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi 023;011)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sipas gjykimit të GVJ elementet e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale janë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", si edhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019.</p> <p>Kurrikula dhe programet e lëndëve (syllabuset), të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale, janë në përputhje të plotë me VKM-ët e mësipërme.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale" është një program studimi i ciklit të parë. Ka një kohëzgjatje normale prej tre vitesh akademike dhe plotësohet me 180 ECTS. Forma e studimeve të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale" është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është gjuha shqipe. Pas përfundimit të kërkesave për diplomim nga programi i studimit në fjalë, studentit i lëshohet diploma "Bachelor" në Inxhinieri Materiale.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi 023;011;010; 012; 013)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të</p>	<p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi Shtojca Nr.1, VKM nr 41, date 24.12.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet arsimi të lartë") lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Në kategorinë A bëjnë pjesë 7 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 20 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë D</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site:www.ascal.al

Faqe 15

<p>përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>bëjnë pjesë 4 lëndë, në kategorinë E bën pjesë 1 lëndë. Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kategoria A 36 ECTS– 20% • kategoria B 93 ECTS = (52)% • kategoria C 27 ECTS = (12)% • kategoria D 15 ECTS = (10%) • kategoria E 6 ECTS = (3%) <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. Rekomandohet që lëndet me zgjedhje të jenë vertetë të tilla dhe jo të paracaktuara. (Metalurgji e metaleve me ngjyra dhe Materiaile Qeramike Tradicionale)</p> <p>Referencë: Referencë: DVV (aneksi 011; tabela përmbledhëse nr 9)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Prodhim Menaxhimit është pjesë përbërëse e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike. Njësia kryesore përgjegjëse për këtë Program Studimi është Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, i cili përbëhet nga 4 njësi bazë, të cilat plotësojnë kriteret ligjore për funksionim, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Energjitikës 2. Departamenti i Mekanikës 3. Departamenti i Prodhim Menaxhimit 4. Departamenti i Tekstili dhe Modës <p>Per vitin akademik 2019-2020</p> <p>Personeli Akademik Efektiv i njësisë baze 19 staff, përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Profesorë Dr. - 3 Profesor i Asoc. Dr. - 13 Doktorë - 1 MSc <p>Personeli Akademik me Kontratë i njësisë bazë 18, përgjegjës për programin e studimit, përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Profesor i Asoc. Dr. - 1Doktorë - 15 MSc

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423
web site:www.ascal.al

	<p>Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton ekzistencën dhe përdorimin me efektivitet si të përvojës ashtu edhe burimeve e kapaciteteve.</p> <p>Ne RVB citohet "Departamenti i Prodhim Menaxhimit aktualisht ka një personel akademik prej 19 anëtarësh, prej të cilëve 1 Profesor, 3 Profesorë të Asociuar, 13 Doktorë Shkencash dhe 2 Master i Shkencave, duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e kësaj njësie bazë (Ligji nr. 80/2015, neni 25, pika 4), si dhe 2 personel ndihmës akademik. [Tabela 1&2 Anekset]. <i>Por ky informacion nuk mbeshitet me anekse.</i></p> <p><i>Referencë: Referencë: DVV (aneksi 015; tabela përmbledhëse nr 1 dhe 2 dhe 7)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Regulloren e FIM, programi i studimit menaxhohet nga keshilli i programit të studimit. Në këtë regullore shpjegohen detyrat kryesore të koordinatorit të programit. Programi i Studimit menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), i cili përbëhet nga 5 anëtarë. Anëtarët e KPS propozohen nga departamentet që bashkëpunojnë për këtë program studimi dhe miratohen në Dekanatin e FIM. Drejtuesi i KPS është koordinatori i programit të studimit. Për vitin akademik 2021 - 2022 koordinatori i programit të studimit është profesor I. M. Në përberje të grupit koordinues është edhe një student G. K.</p> <p>Këshilli i Programit të Studimit</p> <p>1. Organizimi dhe menaxhimi i çdo programi studimi, në UPT, në nivel njësie bazë bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), i cili ngrihet pranë njësisë bazë ose njësisë kryesore në rast të programeve të studimit ndërdisiplinore, ekzistuese ose të reja.</p> <p>2. KPS përbëhet nga 3 (tre) anëtarë për programet e studimit të ciklit të dytë, 5 (pesë) anëtarë për programet e studimit të ciklit të parë. Një anëtar përzgjidhet nga radhët e studentëve. Personeli akademik, anëtar i KPS është të paktën i kategorisë "Lektor" me përvojë, jo më pak se 10 vjet, në mësimdhënie pranë njësisë bazë përkatëse dhe është mësimdhënës në programin përkatës të studimit. Në rastet e programit të studimit, ku përfshihen dy ose më shumë Departamente (bachelor në inxhinieri mekanike), anëtarët e KPS duhet të vijnë nga personeli akademik i Departamente bashkëpunuese. Raporti përcaktohet nga departamentet, në bazë të peshës që ka secili departament në atë program studimi. <i>Referencë: DVV (RVB; aneksi 010; 020: 006)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti është njësia kryesore akademike e Universitetit Politeknik të Tiranës, që koordinon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat mësimore-kërkimore. UPT është i përbërë nga 7 (shtatë) fakultete dhe një institut. Autoritetet udhëheqëse akademike janë Dekani dhe Përgjegjësit e Departamenteve. Organi kryesor akademik i fakultetit është Dekanati. Fakulteti Inxhinierisë</p>




	<p>Mekanike, përbëhet nga 4 (katër) departamente që funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuara në rregulloret përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Energjistikës 2. Departamenti i Mekanikës 3. Departamenti i Prodhim Menaxhimit 4. Departamenti Tekstil Mode <p>Nga sa më sipër njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Referencë: DVV (aneksi 001; 005; 015; 006)</p>			
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i Prodhim Menaxhimit është pjesë përbërëse e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.</p> <p>Univeristeti Politeknik i Tiranës ka përmbushur standardet institucionale dhe ka marrë akreditim në nivelin institucional. Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Departamenti i Prodhim Menaxhimit aktualisht ka një personel akademik prej 19 anëtarësh, prej të cilëve 1 Profesor, 3 Profesorë të Asociuar, 13 Doktorë Shkencash dhe 2 Master i Shkencave, duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e kësaj njësie bazë (Ligji nr. 80/2015, neni 25, pika 4)</p> <p>Referencë: DVV (aneksi 024; Tabela përmbledhëse nr 7)</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti është njësia kryesore akademike e Universitetit Politeknik të Tiranës, që koordinon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat mësimore-kërkimore. UPT është i përbërë nga 7 (shtatë) fakultete dhe një institut. Autoritetet udhëheqëse akademike janë Dekani dhe Përgjegjësit e Departamenteve. Organi kryesor akademik i fakultetit është Dekanati. Fakulteti Inxhinierisë Mekanike, përbëhet nga 4 (katër) departamente që funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuara në rregulloret përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 5. Departamenti i Energjistikës 6. Departamenti i Mekanikës 7. Departamenti i Prodhim Menaxhimit 8. Departamenti Tekstil Mode <p>Nga sa më sipër njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Referencë: DVV (aneksi 001; 005; 015; 006)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Prodhim Menaxhimit zotëron informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Materialesh. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga rregullorja e programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, Plani Strategjik i UPT, kodi i etikës, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore, plani mësimor, rregullore e zhvillimit kurrikular, praktika e miratimit të planeve mësimore, etj. Të gjitha informacionet janë të aksesueshme nga të gjithë. Referencë: DVV (aneksi 001; 002; 003; 004; 006; 007; 008; 009; 010; 011; 044)</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale është i strukturuar në 3 vite shkollorë dhe 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 37 lëndë të ndara sipas 3 viteve (13 lëndë ë vitin e parë; 12 lëndë në vitin e dytë; 12 lëndë në vitin e tretë). Në 37 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës, si edhe praktika profesionale. Lëndë të detyrueshme janë 35. Lëndë me zgjedhje janë 2.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra</p>	<p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Në kategorinë A bëjnë pjesë 7 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 20 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 4 lëndë, në kategorinë E bëjnë pjesë 1 lëndë.</p> <p>Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● kategoria A 36 ECTS– 20% ● kategoria B 93 ECTS = (52)% ● kategoria C 27 ECTS = (12)% ● kategoria D 15 ECTS = (10)% ● kategoria E 6 ECTS = (3%) <p>Duke iu referuar kurrikulës së PS Bachelor në "Inxhinieri Materiale", vërehet që krahas lëndëve të përgjithshme dhe atyre praktike në planin mësimor janë parashikuar të zhvillohen edhe lëndë që ofrojnë njohuri të thelluara dhe të përparuara në fusha akademike apo profesionale. Përfshihen këtu lëndë të zhvilluara kryesisht në vitin e tretë dhe që lidhen me materiale polimere, materiale kompozite, metalurgji dhe saldim, qeramik; fonderi; etj</p> <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale është</p>



	<p>organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p><i>Referencë: Referencë: DVV (aneksi 011; tabela përmbledhëse nr 9;023;010; 012; 013)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale" përmban të gjithë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit. Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në rregulloren e PS. Mbështetet në parimin e kontrollit të vazhduar. Mënyra e vlerësimit varet nga tipologjia e lëndës.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi 010; 011;023;)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. Të gjitha këto kritere gjenden në Neni 19 i Rregullores zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT jep informacionin dhe kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve. Institucioni, nëpërmjet Rregullores së programit të studimit, pajis studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranim, transfertë dhe njehsim studimesh. Të gjitha informacionet janë bërë publike dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të universitetit. Bazuar në rregulloren e PS, për t'u pranuar në këtë program studimi kandidati/student duhet të ketë përfunduar me sukses shkollën e mesme, të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të zotërojë një diplomë të shkollës së mesme të përgjithshme me kohëzgjatje tre vjet, ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje katër vjet, ose edhe shkollë të mesme profesionale. <i>Referencë: DVV (aneksi 004; 010;)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë. Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxëniet të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS. Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës ose grup lektorësh të lëndës, rishikohet nga KPS në njësinë bazë</p>




	përgjegjëse për programin përkatës të studimit dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i fakultetit FIM. <i>Referencë: DVV (aneksi 011; 023; tabela përmbledhëse nr 9)</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Universiteti përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e lëndëve, programeve të lëndëve dhe mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga universiteti. Para fillimit të çdo viti akademik zhvillohen takime pune për të parë nevojën e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit. Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga departamenti përkatës. Vendimet për rishikimin e kurrikulave merren mbi bazën e propozimeve të njëjësive bazë. Me qëllim reflektimin e kërkesave të tregut të punës, përvojave më të mira nga universitetet homologe europiane, ndryshimet e objektivave dhe strategjive kombëtare, programet e studimit janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Plani mësimor hartohet/rishikohet nga KPS-ja, miratohet paraprakisht nga departamenti, kontrollohet dhe miratohet nga dekanati i njëjësive kryesore, vlerësohet për plotësimin e standardeve nga Drejtoria e Kurrikulave dhe miratohet nga senati akademik para fillimit të vitit përkatës akademik <i>Referencë: DVV (aneksi 004; 044.)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Neni 55 i statutit të UPT citon: Programet e ciklit të parë të studimeve 1. Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite evropiane (ECTS). Kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike dhe në përfundim lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer. Po ashtu ky program studimi është në linjë edhe me ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al




	<i>Referencë: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ ose punësim të studentëve.	<p>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ ose punësim të studentëve. Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë si matematikë, fizikë, kimi, etj. Më tej kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Në vitin e dytë dhe të tretë zhvillohen lëndë të mirëfillta inxhinierike, që përfshijnë studimin e materialeve dhe kontrollin e tyre, kontrollin dhe menaxhimin e prodhimit të materialeve të ndryshme. Studentët zhvillojnë laboratore në lëndë të ndryshme, praktikë profesionale, si edhe njihen me përdorimin e programeve kompiuterike inxhinierike. Programi studimit synon gjithashtu t'u japë studentëve një përgatitje me spektër më të gjerë, veçanërisht në fushën e Inxhinierisë Materiale. Përmes kësaj synohet t'u ofrohet studentëve perspektiva më të mira lidhur me përshtatjen, fleksibilitetin si dhe integrimin në tregun e punës.</p> <p><i>Referencë: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij (aneksi 011)</i></p>
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.	<p>Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë si matematikë, fizikë, kimi, etj. Më tej kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Një perceptim i fortë i parimeve praktike dhe fizike nxitet dhe promovohet, duke ofruar një shumëllojshmëri mundësish mësimnxënies.</p> <p>Përgjatë programit, studentëve u ofrohen mundësi që të përforcojnë aftësitë e tyre grafike dhe të komunikimit me gojë. Viti i dytë dhe i tretë përbëhen kryesisht nga lëndë themelore të inxhinierisë së materialeve që përfshijnë studimin e materialeve dhe kontrollin e tyre, kontrollin dhe menaxhimin e prodhimit të materialeve të ndryshme. Dy vitet e fundit të programit të studimit i dedikohen studimit të plotë të bazave teorike të shkencës së inxhinierisë së materialeve. Në të njëjtën kohë, zbatimi praktik i njohurive të inxhinierisë të materialeve paraqitet dhe zbatohet përmes detyrave të kursit, projekteve dhe laboratoreve. Studentëve iu ofrohen njohuri menaxheriale, si edhe kryerja e praktikës profesionale. Nga sa më sipër rezulton se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p> <p><i>Referencë: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij (aneksi 011; 023)</i></p>
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Inxhinieria materiale, ashtu sic është thënë edhe më sipër, është një nga degët e para të UPT dhe të FIM (inxhinieri metalurg). Ky program mbart mbi vete të gjithë historinë dhe vlerat e të</p>

	<p>shkuars, gjithashtu eshte perditesuar fale bashkepunimeve te shumta qe programi ka patur me universitete partnere per me shume se 10 vite me IAL Gjermane, dhe tani po vazhdon bashkepunimin me IAL franceze. Pavec kesaj programi i studimit ka nje bashkepunim te thelluar me Politeknikon e Barit. Kjo per historikun e mardhenieve me ketë universitet si dhe ngashmërinë e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Rajonit të Puglias ku ndodhet ky universitet.</p> <p><i>Referencë: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij, (aneksi 011; 023; 031; 051)</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmblyëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuri praktike në tema të ndryshme inxhinierike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës.</p> <p><i>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se praktikat profesionale të studentëve paraqesin mangësi, kjo pjesërisht e justifikuar nga situata e jashtëzakonshme për shkak të pandemisë.</i></p> <p><i>Referencë.: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij(aneksi 010; 023; tabelë përmbledhëse 21 dhe 23)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, konsultohen nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga drejtuesi i departamentit. Si rregull programet e lëndëve/moduleve bazohen në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Shmangiet nga ky rregull argumentohen nga pedagogu i lëndës dhe miratohen nga drejtuesi i departamentit. Gjithashtu eksperiencat dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, si dhe mobilitet e stafit akademik të FIM, në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, kanë ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e syllabuseve.</p> <p><i>Referencë: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij (aneksi 011; 010; 023)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale u ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale. Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Materiale” synon që të formojë inxhinierë</p>



	<p>materiale që të jenë në gjendje të njohin, përdorin dhe konceptojnë materialet e ndryshme. Gjithashtu të zhvillojnë, prodhojnë, drejtojnë dhe mirëmbajnë ciklin e prodhimit të materialeve.</p> <p><i>Referencë: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij (aneksi 011; 010; 023)</i></p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master.</p> <p>Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p><i>Referencë: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij. (aneksi 011; 023)</i></p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti i Prodhim Menaxhimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët industrialë dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut. Ne RVB citohet "Me qëllim formalizimin e këtyre aktiviteteve dhe marrjen e një mendimi sa më institucional si dhe me iniciativën e disa profesorëve emeritus të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në UPT, në datën 26 Maj 2021 u krijua shoqata Alumni/ae e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, AIM (Alumni/ae Inxhinieria Mekanike) (shih: https://fim.edu.al/fim/alumni-ae-inxhinieria-mekanike-aim). Ky organizim do të shërbejë ndër të tjera dhe tërheqjes së një mendimi profesional, që lidhet direkt me tregun e punës, për përmirësimin dhe adoptimin e programeve të studimit ndaj kërkesave të këtij tregu." Kjo iniciativë është për tu vlerësuar pasi rit ndjeshëm numrin e partnereve që japin kontribut në programin e studimit. Për këtë arsye bazuar në aneksin Ref_051, programi ka 55 marrëveshje bashkëpunimi me institucione private dhe 15 me institucione shtetërore. Duhet theksuar që disa prej marrëveshjeve ju ka mbaruar afati.</p> <p><i>Referencë: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.


Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale, është me grada shkencore dhe tituj akademikë, si edhe kualifikim Msc, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. Personeli akademik ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.

Personeli akademik i brendshëm (PAE) sipas viteve rezulton se është me këtë kualifikim (Tabela 7):

	2019-2020	2018-2019	2017-2018
Prof. Dr	4	4	4
Prof As	5	5	5
Dr/PhD	19	19	19
Msc (dr në proces)	1	1	1
Asistent me msc	3	3	3
Totali	32	32	32

Personeli akademik i jashtëm (PAK) sipas viteve rezulton se është me këtë kualifikim (Tabela 7):

	2019-2020	2018-2019	2017-2018
Prof. Dr	0	0	0
Prof As	0	0	0
Dr/PhD	1	1	1
Msc (dr në proces)	0	0	0
Asistent me msc	2	2	2
Totali	3	3	3




	<p>Raporti i tyre i llogaritur me ngarkesën në orë mësimore (Tabela 12) rezulton:</p> <p><u>Për vitin akademik 2019-2020 vetëm një lëndë mbulohet plotësisht nga staf me kontratë “Teknikat e Komunikimit dhe Kulture Evropiane” dhe një lëndë ka asistent me gradë msc dhe staf me kontratë “Materialet Metalike”.</u> Të gjitha lëndët e tjera mbulohen nga staff efektiv.</p> <p>Pra plotësohet kriteri ligjor për PAE që ka mbështetur me mbi 70% ngarkesën mësimore</p> <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Inxhnieri Materiale" zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë.</p> <p><i>IAL nuk vuri ne dispozicion tabelat per satfin akdemik te Dep apo dhe pergjegjes te programit te studimit per v.a. 2020-2021 dhe 2021-2022</i></p> <p><i>Referencë: Aneks, Tabelat përmbledhëse 12 dhe 7 si dhe aneksi 024</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Inxhnieri Materiale" zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi 024)</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit të zhvilluar me stafin akademik, u konstatua se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik që mbulojnë programin e studimit Bachelor në "Inxhnieri Materiale" është në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit dhe moduleve të tij. Specifikisht, stafi akademik është i specializuar në disiplina të ndryshme të Inxhinirisë së Materialeve si: Metalurgji, Polimere, Qeramika, Prodhim dhe Menaxhim, etj. Lëndët ofrohen nga pedagogë me tituj akademikë dhe disa lëndë mbikëqyren nga disa pedagogë.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi 024; 011)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit ose kompani të ndryshme. Marrëveshjet realizohen nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Zyrës Ndërkombëtare, me qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të ciklit të parë të studimeve në Inxhinieri Materiale. Departamenti gjithashtu mbështet marrëdhëniet me</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423
web site:www.ascal.al

Faqe 26



e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	ndërmarrjet / punëdhënësit. Me qëllim vendosjen e kushteve për mënyrën e hartimit, kryerjes, vlerësimit dhe rishikimit të programit të praktikës profesionale në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në FIM është miratuar dhe zbatohet Procedura e Organizimit të Praktikës Profesional <i>Referencë: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj dhe për praktikën profesionale DVV (aneksi 051; 052; 053; 058; 059)</i>
--	---

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në departament ka një personel ndihmës akademik. Ky personel kujdeset për mirëmbajtjen e paisjeve laboratorike e mjediseve të tjera mësimore si dhe të teknologjisë së informacionit që përdoret në procesin mësimor. Për lëndët të cilat janë jashtë FIM si: Fizikë, Kimi, Informatikë, shfrytëzohen laboratorët e njësisë të tjera bazë të cilat kanë personel ndihmës akademik përkatës.
---	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UPT ka përgatitur dokumentë, të cilët udhëzojnë pedagogët për mënyrën e hartimit të syllabuseve, për metodat e mësimdhënies, përzgjedhjen e literaturës, etj. Në planin strategjik të IAL është përcaktuar se UPT synon të jetë lider në përdorimin e teknologjisë së informacionit në fushën akademike. Universiteti organizon trainime të personelit akademik, veçanërisht të asistent lektorëve. Gjithashtu UPT ka platformën dixhitale për informimin e studentëve. Gjatë periudhës së pandemisë u gjenerua edhe manuali i mësimit online në distancë. Të gjitha këto e bëjnë mësimdhënien inovative. Gjatë takimit me studentët dhe me stafin na u tha që veëm disa prej lëndëve përdorin metoda të avancuara të mësimdhënies që konsistojnë në prezantime, diskutime, punë në grup etj. GVJ rekomandon që kjo të masivizohet në të gjitha lëndët e programit të studimit. <i>Rerencfë: DVV (aneksi 002; 038; 042)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Institucioni kryen monitorimin sistematik të stafit nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen nga studentët. Vlerësimi synon përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Vlerësimi kryhet me metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të fshehta, duke përfshirë studentët. Janë përgatitur formularët e vetëvlerësimit, si edhe formularët e vlerësimit të studentëve. <i>Gjatë takimit me studentët na u tha që disa prej pedagogëve qëndrojnë në klasë gjatë plotësimit të anketave dhe kjo krijon presion tek studentët dhe nuk i lejon ata të shprehin lirshëm.</i> Gjatë takimit me NJSBC na u sqarua që FIM ishte i vetmi fakultet që përgjatë dy viteve ka kryer procesin e vlerësimit të performancës së stafit akademik në mënyrë manuale dhe jo online. Për vitin akademik 2021-2022 ky proces është kryer online. <i>GVJ rekomandon ti kushtohet më shumë vëmendje procesit të mbledhjes së informacionit nga studentët dhe të nxiten ata të shprehin mendimin e tyre lirshëm.</i> Gjithashtu <i>GVJ rekomandon që rezultatet të shpërndahen në mënyrë individuale tek secili profesor për secilën lëndë në mënyrë që stafi akademik të ketë një informacion të plotë për secilën lëndë që ai/ajo ligjëron.</i> <i>Rerencfë: DVV (aneksi 065)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucion siguron përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. Metodat e përdorura janë ato të anketimit të studentëve duker ruajtur anonimat. Për vitin akademik 2021-2022 ky proces u krye nëpërmjet platformës PITAGORA. <i>Rerencfë: DVV (aneksi 065; 108)</i></p>

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në mënyrë shumë të kujdesshme, për të mos cënuar në objektivitetin e kryerjes së detyrës nga pedagogu. Gjithsesi departamentit ia bën të ditur rezultatet e vlerësimit personelit akademik. Më tej departamentit analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, si edhe nxjerr përfundimet përkatëse. FIM në mënyrë periodike organizon çdo vit analiza vjetore e punës mësimore një nga pika e së cilës është edhe analiza e cilësisë së mësimdhënies</p> <p>Gjatë takimit me NJSBC na u tha që për secilin pedagog jepet një vlerësim i përgjithshëm për të gjitha lëndët që ai jep. <i>Rekomandohet që vlerësimi që i përcillet departamentit dhe profesorit të jetë specifik për secilën lëndë. Rerencfë: DVV (aneksi 048)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni promovon shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të shquara. Nga ana tjetër, institucioni është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit si Erasmus + KA1 ose KA2, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse. Gjithashtu, institucioni promovon shembujt e praktikave më të mira përmes mjeteve të tij të komunikimit siç janë emaili ose faqja e internetit e universitetit.</p> <p><i>Rerencfë: DVV (aneksi 066)</i></p>			
<p>Shtylla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj.</p> <p>Ndarja e tyre në program është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 1194 orë në auditor - Seminare 751 orë në auditor - Ushtrime / Laboratorë 140 orë në auditor - Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor 39 orë mësimore - Praktikë profesionale 138 orë mësimore

	<ul style="list-style-type: none"> - Diploma/Provimi formimi 30 orë mësimore - Gjithsej 2292 orë mësimore <p>Përveç kësaj departamenti organizon edhe leksione të hapur me ekspertë të fushës së materialeve.</p> <p><i>Referencë: Tabela 13 në tabelat përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Mësimdhënia në UPT rezulton e larmishme, në varësi të specifikave të lëndëve dhe nevojave të studentëve. Ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë studentët, pavarësisht nivelit të përgatitjes së tyre. Format e mësimdhënies mbajnë parasysh rezultatet e vlerësimeve të ndryshme, të kryera herëpashere.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe ëorkshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Nga ana tjetër, Departamenti i Prodhim Menaxhim ofron metoda pedagogjike të larmishme dhe fleksibile përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punën laboratorike, japin detyra kursi dhe projekte, zhvillojnë prezantime etj. Gjatë pandemisë u kryen edhe klasa virtuale. Departamenti ka organizuar disa aktivitete me përfaqësuesit e industries së prodhimit të materialeve për të kuptuar më mirë pritshmëritë e tregut. <i>Referencë: Plani strategjik i UPT, aneksi 023; 068)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Ky vlerësim fillon që në fazën e rekrutimit. Gjithashtu, gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve të programit tek stafi akademik, e cila realizohej duke u bazuar në fushat e ekspertizës. Nga ana tjetër, personeli akademik përmirësohet vazhdimisht duke marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe aktivitete trajnimi, si dhe organizon aktivitete trajnimi brenda UPT.</p> <p><i>Referencë: Plani strategjik i UPT, aneksi 049)</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke</p>	<p>Nëpërmjet mënyrave të ndryshme institucioni thith mendimet dhe sugjerimet e studentëve në lidhje me problematikat e procesit mësimor. Pas kësaj titullari i lëndës kryen verifikimet përkatëse dhe propozon masat përkatëse, për përmirësimin e procesit mësimor.</p>



reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.									
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe nga bisedat me studentët konstatoi se metodat e mësimit janë ato klasike, duke u përpjekur të përfshijnë studentët sa më shumë në diskutime dhe zgjidhje të situatave konkrete, shoqëruar me kalkulimet përkatëse dhe vizatimet grafike.								
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet laboratorike, inkurajojnë ndjenjën e pavarësisë së studentit, punën në grup dhe të menduarit kritik. Në të njëjtën kohë ofrohet mbikqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues, në të cilin studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre. <i>Referencë: aneksi 023</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesit dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi i mësimit dhe ai shkencor kryhen në ambiente të përshtatshme dhe cilësore, të cilat mirëmbahen dhe ruhen si duhet. Institucioni ka pasur ambiente cilësore që nga fillimi i tij dhe është rinovuar së fundmi. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike zhvillon aktivitetin, duke përdorur në mënyrë të përbashkët me dy njësi të tjera kryesore dhe me Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dy godina, godinën e Korpusit Qendror të UPT dhe godinën e Shtesës së Korpusit Qendror të UPT. Një ekip me teknikë është i punësuar, që të përkujdeset për të gjitha objektet, përfshirë materialet, sistemin elektrik, bibliotekën, etj. <i>Referencë.: Infrastruktura në funksion të programit të studimit. aneksi 070: 071</i>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Ambientet e dedikuara për procesin e mësimit janë të kompletuara mirë me pajisjet e nevojshme, duke përfshirë projektorë, kompjuter në laboratorë dhe instrumente eksperimentale, internet, etj. Gjithashtu, studentët e inxhinierisë së materialeve kanë mundësinë që të zhvillojnë seancat e tyre laboratorike në laboratorët përkatës, të cilët ofrojnë mundësinë për të kryer prova dhe studime shkencore në të gjitha nëndisiplinat e inxhinierisë së materialeve. Gjithashtu studentët e PS Bachelor në Inxhinieri Materialeve për lëndët që mbulohen nga fakultetet e tjera të UPT (Fizika, Kimia, Informatika,

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423
web site:www.ascal.al

	Gjuha e Huaj, Bazat e Elektroteknikës, etj.) shfrytëzojnë laboratorët përkatës të këtyre fakulteteve. <i>Referencë: Infrastruktura në funksion të programit të studimit aneksi 070; 054; 072</i>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të ndryshme informatike dhe infrastrukturë të konsoliduar të IT-së të nevojshme për procesin e mësimdhënies. Sistemi PITAGORA bën të mundur që studenti në kohë reale të njihet me materialet e depozituara nga pedagogët.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni vë në dispozicion një numër të përshtatshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës. Literatura është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. Universiteti gjithashtu ka arritshmëri në një numër bibliotekash online. <i>Referencë: Infrastruktura në funksion të programit të studimit aneksi 074</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka ka një fond librash për secilin nga programet e studimit të ofruar nga Universiteti. Titujt e librave vlerësohen si të mjaftueshëm për përfundimin e suksesshëm të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale". Biblioteka pasurohet çdo vit. Librat e bibliotekës janë inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe temave. Literatura e bibliotekës mund të gjendet në gjuhë të ndryshme si: anglisht, shqip, frëngjisht etj. Librat e blerë janë zgjedhur sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik. Biblioteka Shkencore e Universitetit Politeknik është institucion kulturor dhe informues dhe e ushtron veprimtarinë e vet në shërbim të procesit mësimor, edukativ, të formimit profesional dhe të veprimtarisë shkencore të Universitetit Politeknik të Tiranës. Biblioteka ka 75 vënde leximi dhe 65570 tituj. <i>Referencë: Infrastruktura në funksion të programit të studimit aneksi 074</i>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë bibliotekat online të fushave të përafërta me programin e studimit. UPT ofron ULIBRARY si një platformë aksesimi librash online. Gjithashtu, për ti ardhur në ndihmë studentëve dhe stafit akademik për kërkimin më të lehtë të informacioneve si dhe vendodhjen e tyre në biblioteka të ndryshme, Biblioteka Shkencore e UBT-së, është bërë pjesë e platformës Cobiss
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave	Studentët e inxhinierisë së materialeve kanë mundësinë që të zhvillojnë seancat e tyre laboratorike në laboratorët përkatës, të cilët ofrojnë mundësinë për të kryer prova dhe studime shkencore në të gjitha nëndisiplinat e inxhinierisë së materialeve. Gjithashtu studentët e PS Bachelor në Inxhinieri



dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Materialesh për lëndët që mbuloohen nga fakultetet e tjera të UPT (Fizika, Kimia, Informatika, Gjuha e Huaj, Bazat e Elektroteknikës, etj.) shfrytëzojnë laboratorët përkatës të këtyre fakulteteve <i>Referencë: Infrastruktura në funksion të programit të studimit aneksi 054; 072</i>			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Stafi akademik përdor rregullisht e-learning. Në funksion të mësimdhënies personeli akademik përdor platformën UPT PITAGORA dhe Google classroom, zoom dhe google meet. Gjithashut edhe microsoft teams. <i>Referencë: Infrastruktura në funksion të programit të studimit aneksi 068; 043</i>			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Nëpërmjet UPT PITAGORA personeli akademik dhe studentët shkëmbejnë informacione dhe material të ndryshme. Studenti ka arritshmëri në materialet e depozituara nga pedagogu, ku përfshihen leksione, ushtrime, etj.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Departamenti vë në dispozicion të studentëve listën emërore të anëtarëve të stafit akademik, të cilët mund të udhëheqin tema diplomash. I gjithë procesi, duke filluar nga miratimi i temës së diplomës e deri tek dorëzimi, është rregulluar me një procedurë të standardizuar. FIM ka hartuar dhe miratuar "Procedurën e konceptimit dhe mbrojtjes së diplomës së ciklit të parë bachelor në FIM". Udhëheqësi i punimit të diplomës ka përgjegjësinë e drejtimit të punës për realizimin e punës praktike, aplikative si edhe për orientimin e studentit diplomant në shfrytëzimin e literaturës relevante <i>Referencë: DVV aneksi 060;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë	Në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë është krijuar komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë si një strukturë autonome dhe përhershme DSBC dhe Drejtoria e Kurrikulave. Këto instanca janë përgjegjëse për respektimin dhe përmirësimin e planeve mësimore, cilësisë së mësimdhënies etj. DBSC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore, duke propozuar ndryshime dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al

<p>kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>përmirësime, të cilat i gjykon të arsyeshme. Komisioni bashkëpunon dhe bashkëvepron me njësitë kryesore dhe bazë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Veprimtaria e DBSC është pjesë e statutit të UPT. <i>Referencë: DVV aneksi 001</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Zv Dekani për verimtarinë mësimore është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin studimor Bachelor në Inxhinieri Materiale. Këshilli i programit studimor ndjek dhe menaxhon programin e studimit në Inxhinieri Materiale. Bazuar në Regulloren e FIM, programi i studimit menaxhohet nga keshilli i programit të studimit. Në këtë regullore shpjegohen detyrat kryesore të koordinorit të programit. Programi i Studimit menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), i cili përbëhet nga 5 anëtarë. Anëtarët e KPS propozohen nga departamentet që bashkëpunojnë për këtë program studimi dhe miratohen në Dekanatin e FIM. Drejtuesi i KPS është koordinatori i programit të studimit. Për vitin akademik 2021 - 2022 koordinatori i programit të studimit është profesor I.M. Në përberje të grupit koordinues është edhe një student G.K. <i>Referencë: (RVB; aneksi 006; 004; 010; 020; 006)</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Prodhim Menaxhimit së bashku me FIM dhe KPS, si njësitë bazë për cilësinë e mësimdhënies, si dhe komisioni i përhershëm për sigurimin e cilësisë, struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Metodot kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore, leksioneve të hapura, praktika laboratorike, aplikime studimore, ndërveprimet me të ftuar nga fusha e ndërtimit, praktika profesionale, vizita në terren, etj. FIM ka si objektiv rritjen e kapaciteteve të tij akademike dhe laboratorike duke i dhënë nxitje të mësuarit kreativ dhe njëkohësisht rritjen e bashkëpunimit në projekte shkencore me partnerët e vet ndërkombëtarë. Krijimi i një mjedisi sa më social në shërbim të studentëve. Stafi akademik në FIM është gjithmonë i vëmendshëm në marrjen e informacionit të përditësuar në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies. Kështu stafi akademik ka autonomi të plotë në hartimin e syllabuseve të lëndëve duke u inkurajuar të implementojnë vazhdimisht metodologji të reja mësimdhënies të cilat përmirësojnë cilësinë e saj <i>Referencë: (RVB; aneksi 002; 007; 023)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik të angazhuar në programin studimor, si dhe pas shqyrtimit të CV, konstatohet që personeli akademik dhe ndihmës përfshihen në projekte shkencore rajonale/ndërkombëtare, projekte profesionale, seminare, ëorkshop-e, konferenca në fushat përkatëse të kërkimit shkencor. Në aneksin 076 faqe 15 përmendet aktiviteti kërkimor shkencor i departamentit të Prodhim Menaxhimit, pjesë e së cilit është edhe programi i studimit. Me saktësisht në tabelën faqen 23 të te njejtë dokument jepet përmbledhja e aktivitetit shkencor të stafit të departamentit. Në këto tabele konstatohet që i gjithë stafi, me përjashtim të</p>

	2 profesoreve, jane te perfshire ne KA1, projekte nderkombetare ose projekte te financuar nga AKKSHI. <i>Referencë: DVV, Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit. Tabelat përmbledhëse 1 dhe 2, aneksi 076; 024;</i>			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Institucioni organizon në mënyrë periodikeëorkshope dhe aktivitete të ndryshme trainimi, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore. Këto aktivitete realizohen falë bashkëpunimeve me projekte ndërkombëtare, marrëveshje me institucione të tjera, etj. Ne vitin 2019 jane realizuar 125 mobiloitete qe ndikojne direkt ne trajnimin e vazhdueshem te stafit dhe studenteve dhe ne vitin 2020 jane realizuar 19 mobilitete. UPT dhe FIM kane shpenzuar per avancimin e stafit 14,100,005 All per vitin 2019 dhe per vitin 2022 1,414,359 All. Kjo tregon deshiren dhe gadishmerine e institucionit per te mbeshetur stafin e vete ne drejtim te avancimit ne karriere <i>Referencë: DVV,(aneksi 066; 067)</i>			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Bazuar në statutin e UPT, si dhe në rregulloren e fakultetit ku bën pjesë programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale, personeli akademik i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale është përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe është i angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim. Një ndihmë për përmirësimin e aftësive të tyre dhe implementimin e metodave të reja janë dhe trajnimet e tyre në Universitetet të huaja pe:ëndimore. <i>Referencë: DVV,(aneksi 004; 006)</i>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ u prezantua me aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik teston metoda të reja mësimore. Personeli akademik është i lirë të implementojë metoda e forma inovative të mësimdhënies, t'i analizojë ato, të reflektojë anët pozitive dhe negative, duke kryer edhe ndryshimet përkatëse në silabuset e lëndëve dhe metodat e mësimdhënies e nxënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive	Rregullorja e vlerësimit të dijeve për programin e studimit BSc në Inxhinieri Materiale përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjithçka i bëhet e qartë studentit gjatë javës së parë nëpërmjet prezantimit të sylabusit ku janë të përcaktuar edhe kriteret e vlerësimit, si edhe nga pedagogët e lëndëve. <i>Referencë: DVV, aneksi 041; 023</i>								
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në javën e parë të semestrit akademik studentët njihen me programin e lëndës, përmbajtjen e saj, si edhe formën e vlerësimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në çdo silabus, në bazë të tipologjisë së lëndës, përcaktohet edhe vlerësimi i studentëve. <i>Referencë: DVV, aneksi 041; 023</i>								
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në shqyrtimin e silabuseve të lëndëve në programin studimor, në rregulloren e PS, si edhe në bisedat me studentët, njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes këtyre formave kryesore: Detyra Kursi Projekte kursi Provime të ndërmjetme (testimeve gjatë semestrit) Kontrolli i relacioneve të punëve laboratorike. Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) mund të bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor. Gjithashtu edhe ndjekja dhe pjesëmarrja në lëndë vlerësohet me 5% <i>Referencë: DVV, aneksi 023, tabela përmbledhëse nr 15</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të PS konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Janë përcaktuar periudha kohore të dedikuara për provimet, provimet e ndërmjetmde provimet përfundimtare. Kontrolli i dijes në një lënde bëhet në mënyrë të vazhdueshme, i shtrirë përgjatë kohës së zhvillimit të lëndës. Gjithashtu FIM ka rregulloren e provimeve, dhe me specifikisht provimet detajohen ne sylabusin e seciles lende (frekuenca e provimeve dhe menyra e vleresimit) <i>Referencë: DVV, aneksi 023, 004 dhe 041</i>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423
web site:www.ascal.al

Faqe 36


<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Aktualisht, në UPT, nuk ka në zbatim një sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve avantazhet e të cilit do të rrisin transparencën dhe mundësonin reduktimin në maksimum të abuzimit dhe subjektivitetit në vlerësimin e studentëve. <i>Referencë: RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Provimet vlerësohen nga pedagogu dhe asistenti i lëndës. Praktika profesionale, si edhe punimi i diplomës vlerësohen detyrimisht nga komisioni përkatës. Nëse lënda është zhvilluar nga një pedagog, drejtuesi i njësisë bazë cakton një anëtar tjetër të stafit akademik, të afërt me atë disiplinë. Nëse lektori i lëndës ose pedagogët e përfshirë në mësimdhënie, për arsye madhore nuk mund të marrin pjesë në provim, drejtuesi i njësisë bazë propozon pedagogët që do t'i zëvendësojnë, të cilët miratohen nga dekan, <i>Referencë: DVV, (aneksi 004; 041)</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturë të mjaftueshme për zhvillimin e provimeve në anonim të plotë. Aplikohet sekretimi i fletëve të provimit, mbikqyrja e sallave nga dy pedagogë të caktuar nga drejtuesi i departamentit. Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi deri sa dorëzohen në sekretari. <i>Referencë: DVV, (aneksi 004; 094)</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pike/ notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi. Gjatë takimit me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv mbi komentet, këshillat dhe rekomandimet e pedagogëve në mënyrë që të ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Universiteti, nëpërmjet rregulloreve të tij, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Gjatë zhvillimit të provimeve salla monitorohet nga dy apo më shumë pedagogë të caktuar e të miratuar nga drejtuesi i departamentit. Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohen rëndë. Kjo sanksionohet në kodin. e etikës së UPT <i>Referencë: DVV, (aneksi 003)</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura. Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritën e studentëve.</p>



<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregulloreve, si dhe gjatë vizitës në universitet u konstatua se studentët e nuk e ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi. Ata ndiheshin jo komod në ankesën e notës pasi u shprehën që profesorët hakmerren nëse ndaj tyre ngrihet një komision ankimimi. Ankesa paraqitet në formën e një kërkesë të veçantë pranë sekretares së dekanit, brenda 3 ditëve pas shpalljes së notave përfundimtare. Gjatë takimit me profesorët na u tha që i njëjti profesor (titullar i lëndës) është pjesë e komisionit të rivlerësimit.</p> <p><i>GVJ Rekomandon që të rishikohet procedura e ankimit të notave dhe të nxiten studentët të shprehin lirshëm ankesat e tyre.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i dekanatit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën.</p> <p>Çdo ankesë nga studentët për vlerësimin në provime shqyrtohet nga Dekani dhe Zv. Dekani për veprimtarinë mësimore, të cilët mund të thërrasin për sqarime drejtuesin e departamentit përkatës, komisionin e vlerësimit dhe vetë studentin. Pas gjykimit të çështjes, merret vendim i formës së prerë, brenda tri ditëve pune. Kur ankesa është e drejtë, dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentin është ankuar dhe vendos që studentin të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë. <i>Referencë: RVB aneksi 041</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjeve së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtë-kurrikulare, siç janë leksione të hapura, vizita në terren, etj. <i>Referencë: Plani mësimor i PS, programet e lëndëve (aneksi 010; 011; 023)</i></p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Për të përmbushur këtë kriter në planin mësimor të PS përfshihen lëndë të tilla si Bazat e Informatikes; Gjuhe Angleze; Teknikat e Komunikimit dhe Kulture Evropiane etj. <i>Referencë: Plani mësimor i PS, Tabela përmbledhëse nr 9.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe silabuset e çdo lënde, analizohen në përfundim të semestrit akademik. Pedagogët tërheqin mendimin e studentëve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të përmbajtjes së lëndëve. Si një test për të kuptuar se sa kanë përfituar studentët shërben edhe detyra e kursit apo detyra praktike. <i>Referencë: Plani mësimor i PS, programet e lëndëve (aneksi 023)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion, me stafin akademik dhe me studentët u konfirmua qënë përfundim të çdo lënde pedagogu thekson problemet më të rëndësishme, të cilat do t'u nevojiten studentëve, duke i këshilluar ata për mënyrën e implementimit të tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i FIM angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizonëorkshope, si dhe zhvillon aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga drejtuesit e programit të studimit janë organizuar orë të hapura dhe seminare me perfaqesues të industrisë (Alumil) apo profesor të ftuar në kuader të marrëveshjeve nderinstitucionale. Gjithashtu përmes ftesës së profesorëve të huaj është bërë e mundur organizimi i seminareve dhe trajnimeve të hapura për studentët <i>Referencë: Tabela përmbledhëse nr 19.</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpercaktuara në programet lëndore. Studentët e programit Bachelor në Inxhinieri Materiale kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët e inxhinierisë së ndërtimit, si dhe në praktikat profesionale. <i>Referencë: Plani mësimor i PS, programet e lëndëve (aneksi 023)</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Bachelor në Inxhinieri Materiale. <i>Referencë: Kurrikula e programit të studimit aneksi 023; 011</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative,</p>	<p>Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete</p>



studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	kombëtare dhe ndërkombëtare. Ne RVB citohet "Gjithashtu në FIM është bërë tashmë një praktikë e mirë organizimi i Konferencave Studentore, ku studentët nën drejtimin e pedagogëve bëjnë referime të ndryshme rreth zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë" <i>Referencë: DVV (aneksi 078; 079)</i>			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga vizita në UPT konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore. Kjo realizohet duke i përfshirë studentet në mobilitete, vizita në teren, detyra kurse të detajuara, etj <i>Referencë: DVV (aneksi 078; 079)</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve, lista e të cilave është vënë në dispozicion të GVJ. UPT shkëmben përvojën e tij me këta universitete duke mundësuar rritjen e mobiliteteve të studentëve. <i>Referencë: DVV (aneksi 049; 066)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Procedura për mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është e hartuar dhe zbatohet në nivel fakulteti të FIM. Kjo procedurë zbatohet nga Departamentet që mbulojnë një program studimi, dhe nga studentët diplomantë në periudhën e përgatitjes së temës të Punimit të Diplomës dhe gjatë mbrojtjes së tij. <i>Referencë: DVV (aneksi_060)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion në lidhje me procesin e mbrojtjes së diplomës, GVJ konstaton se Departamenti krijon një fond të temave të diplomave për çdo vit akademik, publikon temat për studentët dhe përcakton studentët që do të kryejnë diplomën, ngre komisionin e mbrojtjes së diplomës dhe kryen kontrollin përfundimtar të punimit të diplomës. Kontrolli i mbarëvajtjes dhe zbatimit të kësaj procedure është përgjegjësi e Dekanit të FIM. Ndërkohë udhëheqësi i punimit të diplomës ka përgjegjësinë e drejtimit të punës kërkimore. <i>Referencë: DVV (aneksi_060)</i>

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Të gjithë studentët e PS Bachelor në Inxhinieri e Materiale i finalizojnë studimet e tyre përmes mbrojtjes së diplomës.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_060)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në takimin me departamentin GVJ konstaton se: Departamenti përgatit një fond temash diplome të cilat miratohen nga Dekani i FIM. Më pas keto tema vihen në dispozicion të studentëve të cilët përzgjedhin temën dhe departamenti i përcakton me miratimin e dekanit një udhëheqës relevant me temën e përzgjedhur. Udhëheqësi i diplomës është personi përgjegjës i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekani i FIM, për të drejtuar punën studimore dhe laboratorike të diplomës. Studenti Konsultohet rregullisht me udhëheqësin, i cili e asiston dhe monitoron studentin gjatë gjithë procesit të punimit të diplomës. Gjatë takimit me stafin u mësua se departamenti organizon dy kontrole të temës para mbrojtjes finale. <i>Referencë: DVV (aneksi_060)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët e PS Bachelor në Inxhinieri e Materiale mund të përdorin infrastrukturën që FIM vë në dispozicion të procesit mësimor dhe shkencor, mjediset në biblioteka, salla kompjuterësh dhe shërbime të tjera, që FIM ofron për studentët. Bazuar në vizitën në institucion u konstatua se një pjesë e studentëve kishin kryer punime të temave të diplomave duke kryer punime në laboratorët e departamentit, por nga ana tjetër studentët kishin shume pak informacion në lidhje me bibliotekën dhe nese kishin literaturë të disponueshme. Shumica prej tyre nuk kishin qenë asnjeherë ne ambientet e bibliotekës. <i>Referencë: DVV (aneksi_006, 004, 054)</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton se udhëheqësi i punimit të diplomës ndjek punën e studentit për realizimin e punës praktike, aplikative si edhe për orientimin e studentit diplomant në shfrytëzimin e literaturës relevante. Udhëheqësi përgatit programin e punës së studentit, dhe vendos afatet e realizimit të tij. Programi i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e punimit, duke firmosur në formularët përkatës. <i>Referencë: DVV (aneksi_060)</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konstaton se në përfundim të mbrojtjes së diplomës, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon studentit notën, me të cilën është vlerësuar punimi i tij, e cila është mesatarja e vlerësimit nga çdo anëtar i komisionit. Nota regjistrohet në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Studentët kanë të drejtë të rimbrotjnë temën e diplomës në rast se rezultojnë të pasuksesshëm herën e parë. <i>Referencë: DVV (aneksi_080, 060)</i></p>

<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha detyrimet dhe kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë përmbylljen e 180 ECTS, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. <i>Referencë: DVV (aneksi_012, 004, 055)</i></p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ konstaton se në përfundim të studimeve me kërkesë të tij studentit i vihet në dispozicion programi i plotë i studimit Bachelor në Inxhinieri Materiale në gjuhën shqipe ose anglisht i nënshkruar në çdo faqe nga Zv. Dekani për anën mësimore. <i>Referencë: DVV (aneksi_081)</i></p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/ konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni ka krijuar një bazë të dhënash të plotë për të gjithë procesin mësimor në vite. Dokumentacioni ruhet për një periudhë pa afat. Të dhënat statistikore përpunohen periodikisht sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, agjencisë së sigurimit të cilësisë, apo të vetë institucionit. <i>GVJ gjatë vizitës në UPT dhe në sekretarinë mësimore, specifikisht gjatë kontrollit të rregjistrave, u vu re që kishte shumë korigjime, si në nota ashtu edhe në të dhënat e studentëve. Për këto korigjime, të bëra me korrektor, nuk kishte asnjë procesverbal të mbajtur nga personat përgjegjës dhe kryesekretarja. Për këtë arsye dhe për rëndësinë që ka ruajtja dhe dokumentimi i saktë i të dhënave, GVJ rekomandon shtimin e një rregulloreje apo procedure se çfarë ndodh në rast se bëhet një gabim njerëzor në regjistrat hard copy. Korigjimi i rregjistrave është një ndërhyrje e cila nuk duhet të ndodh pa procesverbalin përkatës. <i>Referencë: DVV. RVB</i></i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			X	
<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			X	


**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Referuar DVV si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se në FIM mblidhen, ruhen dhe përditësohen çdo vit akademik të dhënat personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe ato të personelit ndihmës. Në lidhje me mbledhjen e këtyre të dhënave FIM nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore. Ruajtja dhe përditësimi i të dhënave bëhet në dosjet e personelit Dosjet hard copy u konsultuan nga GVJ gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe u konstatua se dosjet e PAE mbaheshin në zyrën qendrore të Burimeve njerëzore të FIM ndërsa dosjet e PAK mbaheshin e departament. GVJ konstatoi që dosjet përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara dhe vetë të dhënat janë të përditësuara.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_093, takimi me zyrën e burimeve njerezore)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni ka të hartuara dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik bëhet në përputhje me Statutin e Institucionit. Departamenti çdo viti akademik analizon nevojat dhe kërkesat për stafin akademik dhe përgatit një dokument të planit të ngarkesave mësimore për stafin aktual. Në këtë mënyrë parashikon se cilat janë nevojat për staf te cilat ia percjell drejtuesit te njesise kryesore. Pozicionet vakante dhe kriteret e nevojshme, behen publike ne faqetweb të FIM dhe UPT si dhe afishohen ne ambientet e FIM. Thirrja qendron aktive per nje periudhë 10-ditore kalendarike, dhe aplikimet vlerësohen nga nje komision i perbere prej 3 vetash, ku bejne pjesë pergjegjesi i departamentit, pergjegjes te sektoreve apo titullare te lëndëve perkatese. Komisioni dergon i listen me fituesit njesise kryesore e cila e ben publike duke i shpallu emrat fitues ne faqen ueb te UPT. Lista fituese i dergohet rektoratit. <i>Referencë: DVV (aneksi_056, 057, 069)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ i konsultoi kriteret dhe procedurat e posaçme e specifike për rekrutimin e personelit të shenjuara në dokumentat bazë si: Rregulloren e Pergjithshme, Statutin e UPT dhe Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerezore dhe i gjeti ato të hartuara në përputhje të plotë me bazën ligjore dhe të zbatuara gjatë gjithë aktivitetit për rekrutimin e personelit. Këto akte ishin bërë publike edhe në faqen zyrtare të institucionit. <i>Referencë: DVV (aneksi_001, 056)</i></p>



<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi fillimisht RVB ku thuhet se: Institucioni ndjek një politikë të qartë për rekrutimin e stafit me kualifikimin e duhur. Procesi i rekrutimit të stafit bazohet në dispozitat e parashikuara në Procedurat për Rekrutimin e Stafit të Universitetit dhe realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Procesi i rekrutimit mbështetet në nevojat për personel, të cilat i paraqiten Zyrës së Burimeve Njerëzore nga departamenti. GVJ gjykon që kjo procedurë garanton rekrutimin e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e Programit të Studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet e Institucionit. Ai i gjeti këto ambiente të përshtatshme dhe funksionale për kryerjen e detyrave mësimore e kërkimore shkencore. Kjo u pohua edhe nga pjesëtarët e personelit në takimin që GVJ organizoi me ta.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimin me stafin GVJ konstaton që institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik me qëllim aftësimin profesional. Gjithashtu, stafi akademik inkurajohej për të marrë pjesë në projekte të shkëmbimit të stafit “Erasmus+” me universitete të tjera partnere. Anëtarë të stafit u shprehën se nëpërmjet këtyre pjesmarrjeve ata kanë shkëmbyer përvoja dhe janë njohur me politikat e menaxhimit dhe strategjitë e zhvilluara në institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë në Europë dhe jashtë saj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Vihet re që UPT, angazhohet në zbatimin e politikave integruese të personelit të vet akademik, nëpërmjet formave të ndryshme të asistencës, si ofrimin e mundësive për kualifikim dhe zhvillim profesional me ane të pjesmarrjeve në projekte Erasmus+, trajnimeve të ndryshme mbi mësimdhënien online, si dhe mbështetjen financiare për personelin akademik në kualifikimin e tij profesional brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_002, 007, 043, 067)</i></p>




<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton që institucioni dëshmon angazhimin e të gjitha burimeve njerëzore në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit Bachelor. Konkretisht, për PS Bachelor në "Inxhinieri Materiale" pedagogët kryesorë të lëndëve të ofruara në kurikulë zotërojnë të paktën kualifikimin "Master i Shkencave" sipas nenit 59, pika 6 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Po ashtu, sipas CV-ve të tyre ata kanë një përvojë disa vjeçare në fushën specifike të lëndës që zhvillojnë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton që Institucioni vë në dispozicion ambiente të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe natyrën specifike të PS si: auditorët, laboratorët, biblioteka dhe mjediset ndërmjetëse. <i>Referencë: DVV (aneksi_070, 054)</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizites ne institucion GVJ konstatoi se institucioni ve ne sherbim te PS mjedise mësimore si klasa, laboratorë, të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e</p>	<p>FIM zoteronte 15 laboratore, te pajisur me paisjet e nevojshme teknike dhe informatike për të zhvilluar labororet dhe praktikat me studentët si dhe per punet kerkimore shkencore te stafit. Gjithashtu 3 Laboratore te teknologjise se materialeve me te pajisur me pajisjet e</p>



nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	matjes se fortesise dhe me mikroskope elektronike dhe optike ishin ne sherbim te programit te studimit.			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Institucioni siguron gjithsej 12 laboratore për lëndët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit në tërësinë e ambienteve të tij. Çdo sallë informatike është e pajisur me hapësirën e nevojshme për zhvillimin normal të leksioneve/seminareve. Lëndët e teknologjisë së informacionit si p.sh informatika baze apo gjuhët e programimit, mbahen nga personel nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, i cili ka në dispozicion plot 7 laboratore modern dhe të pajisur me programe profesionale. Gjithashtu FIM në ambientet që administron ka një laborator CAD-i i pajisur softuere si AutoCAD 2018 Ky laborator shërben jo vetëm për studentët e FIM por dhe studentët e fakulteteve të tjera që zhvillojnë këtë lëndë. <i>Referencë: DVV (aneksi_054, 072)</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	GVJ konstaton se UPT, ve në dispozicion ambjete të mjaftueshme me ane të cilave garanton zhvillimin proceseve laboratorike për studentët. Keto ambiente përdoren edhe për realizimin e një pjesë të praktikave mësimore profesionale. FIM në mënyrë specifike, me 19 laboratorët që ofron, mundëson që një pjesë e praktikave të mund të kryhen në ambientet e fakultetit. Gjithashtu studentët zhvillojnë praktikat profesionale pranë subjekteve private e shtetërore me të cilat institucioni ka marrëveshje si psh: me kompaninë Alumil dhe Kurum. <i>Referencë: DVV (aneksi_051)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar RVB dhe vizites në ambientet e institucionit UPT ka në dispozicion një bibliotekë shkencore qendrore për studentët e tij, kjo bibliotekë është pjesë e Korpusit Qëndror dhe ndodhet në sheshin Nënë Tereza. Kjo bibliotekë ofron 65570 tituj dhe 75 vende leximi. Gjithashtu vete FIM ka një bibliotekë të pajisur me afro 115 tituj dhe 45 poste studimi. <i>Referencë: DVV (aneksi_074)</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al

Faqe 46




<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe konkretisht në ambientet e bibliotekës ku dhe u zhvilluan pjesa me e madhe e takimeve GVJ konstatoi që ajo ishte e paisur me literaturë fizike: tekste mësimore bazë, literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe periodikë të ndryshëm</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni krijon kushte për akses në një sere bibliotekash sistemesh online si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi COBISS (Co-operative Online Bibliographic System and Services) nga ku studentët mund të lidhen online me 15 biblioteka universitare, 10 biblioteka publike dhe 3 biblioteka speciale në 11 qytete të Shqipërisë. - Portalin e Bibliotekës Digjitale [https://ulibrary.rash.al/] nga ku mund të shfletohen online artikuj shkencorë, mbi 193 mijë libra akademike, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore si dhe 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaj. - (https://ulibrary.rash.al/) e cila ofron një database shumë të pasur me tekste, revista, periodikë etj, dhe aksesohet me kredencialet personale institucionale të secilit student/pedagog dhe pa pagesë <p><i>Referencë: DVV (aneksi_075)</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua se në bibliotekën qendrore ofrohet lidhje me internet me kabëll ose edheëireless, <i>ambientet e bibliotekës nuk janë të pajisura me kompjutera fizik për të lehtësuar konsultimin e titujve online.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni kërkon në mënyrë periodike nga fakultetet që të parashtrijnë kërkesat për tituj dhe vëllime të reja tekstesh. Këto kërkesa shpërndahen në njësitë bazë dhe tek pedagogët. Fakulteti bën një përmbledhje të kërkesave dhe ja paraqet drejtorisë së bibliotekës. Sektori i zhvillimit të koleksioneve dhe biblioteka angazhohen që të blejnë titujt dhe t'i vendosin në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik. <i>Referencë: DVV (aneksi_073)</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit</p>	<p>Oraret e punës të bibliotekës shpallen në mjediset e institucionit: 'Oraret e shërbimit për publikun'. Biblioteka shkencore qendrore është në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al



mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<p>nëpërmjet infrastruktures së saj, ajo zbaton keto orare: e Hënë - e Premte: 8.00 - 19.00, e Shtunë: 8.00 - 14.00.</p> <p><i>Bazuar ne viziten ne institucion dhe vecanerisht nga takimi me studentët GVJ konstatoi se studentët nuk janë shume te informuar ne lidhje me mundesite qe ofrojne bibliotekat institucionit dhe ne pergjithësi nuk i frekuentojne ato. Nje pjesë e studentëve u shprehen se nuk e dinin vendndodhjen e bibliotekes.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>GVJ konstatoi se insitucioni kryen menaxhimin e të dhënave me anë të platformes "Pitagora". Të gjitha zyrat brenda institucionit kanë akses në informacionin për studentët, statusin e tyre dhe ti ndjekjen në vazhdimësi të studimeve të tyre deri në diplomim.</p> <p>Që në momentin e regjistrimit, studentët pajisen me kredencialet për të aksesuar sistemin, dhe me emailt institucionale. Institucioni mbante dosjet e studentëve në sekretarinë mësimore në mënyrë fizike dhe digjitale. <i>Referencë: DVV (aneksi_043)</i></p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri GVJ u informua se përdoret i njeiti sistem menaxhmi. Ky sistem u mundëson personelit akademik, ndihmës akademik, administrative dhe partnerëve aksesim funksional për të menaxhuar aktivitetin e tyre në kuadrin e aktivitetit të përgjithshëm të institucionit.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_043)</i></p>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>GVJ konstatoi që sistemi i sipërpermendur siguron akses të dedikuar. Duke qenëse informacioni ruhet në një bazë qendrore të dhënash edhe stafi edhe studentët kanë akses në informacionin e tyre personal dhe atë që lidhet me programin e studimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me mënyrën e funksionimit të këtij sistemi dhe konkludon që ai është mjaft i dobishëm për informimin, organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve si të studentëve ashtu edhe të stafit aktiv në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale".</p> <p><i>Referencë: DVV (takimi me stafin dhe studentët)</i></p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 22-43423
web site:www.ascal.al

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit i sipërpermendur mundëson forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>GVJ konstaton që sistemi garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Kështu nëpërmjet tij monitorohet frekuentimi i studentëve, llogaritet nota përfundimtare, njoftohet stafi akademik dhe administrativ për të drejtën e hyrjes në provim të studentëve etj. Ky sistem automatizon edhe procesin e plotësimit të kërkesave të studentëve për dokumenta të caktuara duke inicuar dhe ndjekur procesin deri në fund.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi faqen zyrtare në internet të institucionit dhe gjeti që informacionet të cilat lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera të institucionit publikohen në faqen e internetit në shqip dhe në anglisht. <i>Referencë: https://hupt.edu.al/#</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstaton që UPT ka buxhet të pavarur dhe harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për cikël të plotë studimi. Buxheti mer parasysh kërkesën dhe nevojën për burime njerëzore akademike dhe administrative në shërbim të programit, burimet infrastrukturore, logjistike dhe didaktike si dhe investime afatgjata ku përfshihen pajisje për klasat, laboratore dhe investime të tjera. <i>Referencë: DVV (aneksi_099)</i></p>



<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja në funksion të realizimit të programit të studimit. Nga ky informacion ai mësoi që burimi kryesor i financimit ishin të ardhurat nga tarifat e studentëve dhe buxheti i shtetit për arsimin, ndërsa fondet e tjera lidheshin me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_067, 096, 098)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>GVJ mesoi se Institucioni kryen çdo vit auditimin periodik të pasqyrave financiare i cili konfirmon vërtetësinë dhe pasqyrimin drejtë të informacionit financiar. GVJ konkludon se institucioni zotëron burimet e nevojshme financiare për ta mbështetur këtë Program Studimi.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_099, takimi me drejtuesit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ konstaton që ky kriter përmbushet, bazuar në raportimet e bera me siper.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e</p>	<p>Bazuar në raportet financiare GVJ konstaton se institucioni ka bilanc financiar pozitiv, çfarë garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe ekzistencën e kapaciteteve financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare në të ardhmen.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_099)</i></p>



të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al

Faqe 51




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Referuar DVV dhe gjetjeve nga vizita në institucion, GVJ është informuar mbi politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje.</p> <p>GVJ kostaton se ne Statutin dhe Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies se UPT pershkruhen procedurat e pranimit te studentëve si: dispozitat e pergjithshme, aplikimi, transferimi, etj. Këto politika dhe procedura janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit. <i>Referencë: DVV (aneksi_001, 004)</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në shqyrtimin e politikave dhe procedurave për pranimin, edukimin dhe diplomimin e studentëve, GVJ gjykon që ato garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Të gjithë ata që kanë aplikuar për programet e studimit në UPT dhe fitojnë të drejtën e studimit rregjistrohen si studentë zyrtarë dhe u nënshtrohen njëlloj të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga ky status. GVJ konstaton që në këtë institucion, si të drejtat ashtu edhe detyrimet janë të njëjta për të gjithë studentët që nga momenti kur marrin statusin e studentit deri kur diplomohen.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_099)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar ne DVV; GVJ gjykon se procedurat e pranimit, përzgjedhjes së studentëve, ato të përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit ato janë të aksesueshme dhe të kuptueshme nga publiku. Procedurat deri në regjistrim janë procedura konkurruese të cilat gjenden në faqen zyrtare të universitetit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Dekanati miraton kriteret për përzgjedhjen e studentëve te cilat më pas kalojnë në Senatin Akademik te UPT. Keto kriteret hartohen dhe bëhen publike një vit përpara se ato të hyjnë në fuqi dhe shpallen në websitin UPT. Gjithashtu kriteret u bëhen të njohura maturantëve përgjatë aktiviteteve të ndryshme të informimit me ta si psh: Panairtëorë & Study. <i>Referencë: DVV (aneksi_027)</i></p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe</p>	<p>Lidhur me procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në programin Bachelor në Inxhinieri Materiale, GVJ konstaton se ato janë në</p>

<p>zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>përputhje me aktet nënligjore dhe maturën shtetërore, gjithashtu janë të përcaktuara edhe në Rregulloren e Perkatëse, faqen zyrtare të UPT, gjithashtu. GVJ u informua se ato janë publike dhe përditësohen çdo vit akademik sipas legjislacionit në fuqi.</p>								
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe grupeve të informimit të maturanëve në fakultete UPT organizon takime promovuese me kandidatët për studentë në ambientet e gjimnazeve të ndryshëm në vend. Këto aktivitete kryhen edhe në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore përkatëse, si dhe takime pranë Qendrave Rinore për të informuar të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit, të cilat ofrohen në këtë universitet, duke shpërndarë njëkohësisht broshura e fletëpalosje informative dhe informacion të detajuar për çdo program studimi. UPT mban lidhje me Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore për të ndarë informacionin në lidhje me aktivitetet informuese për maturanët si studentë të ardhshëm të UPT</p> <p>Përcjelljen e këtij informacioni për publikun dhe të interesuarit, UPT e realizon edhe nëpërmjet aktiviteteve të tjera të realizuara në koordinim edhe me MASR. Referencë: DVV (aneksi_033, 034, 107)</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="627 1014 820 1115">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="820 1014 1002 1115">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1002 1014 1225 1115">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1225 1014 1439 1115">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni informon studentët në lidhje me kriteret, procedurat e përparimit akademik të tyre, në lidhje me programin e studimit dhe procesin mësimor me anë të disa burimeve të informacionit. Një pjesë të informacionit studentët e gjejnë në Statutin e institucionit, rregulloret, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj të cilat mund ti aksesojnë elektronikisht ose fizikisht. Ndersa informacionin në lidhje me ecurinë e tyre personale e aksesojnë nëpërmjet sistemit PITAGORA.</p> <p>Referencë: DVV (aneksi_004, 006, 025)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni informimone studentët lidhur me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve</p>



<p>procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>të pjesshme. Në këtë kuadër konstatohet që sipas direktivave dhe rregulloreve çdo student, informohet rregullisht për procedurat dhe afatet e njohjes së diplomës së studimeve të mëparshme. Studentët gjithashtu informohen për njohjen e diplomës bazuar në akreditimin e programit të studimit. Kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme jepen në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT dhe në Guidën studentore. <i>Referencë: DVV (aneksi_004, 025)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët mund të gjejnë informacion mbi kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT të cilat janë të aksesueshme në faqen web të UPT. Gjithashtu FIM ka hartuar dhe zbaton një procedurë të veçantë për vlerësimin e dijeve, procedurë e cila është e aksesueshme për stafin akademik dhe studentët në faqen veb të FIM. Ne te njëjten kohë në fillim të çdo semestri, pedagogët që mbulojnë lëndët e programit mësimor Bachelor në Inxhinieri Materiale informojnë studentët në mënyrë më specifike në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet prezantimit të syllabusit. Studentët mund t'i sigurojnë keto informacione edhe nëpërmjet Sekretarisë mësimore të FIM-së, e cila vendos në dispozicion të tyre këtë informacion. <i>Referencë: DVV (aneksi_004, 041, 089)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Edhe në lidhje me këtë kriter GVJ konstatoi se informacioni që i përcillet studentëve është i plotë dhe i qartë. Pasi sic është shpjeguar në hollësi dhe në Standartin III.8. Gjatë gjithë periudhës së punimit të diplomës studentët janë të mbikqyrur dhe të udhëhequr nga një udhëheqës që monitoron dhe mbështet studentin gjatë këtij procesi.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe gjatë takimeve në Institucion, GVJ konstaton se institucioni informon të interesuarit apo studentët e ardhshëm të këtij programi në mënyra të ndryshme, me informacionet më të përditësuara lidhur me programin. Ndërkohë, Zyra e Planifikimit të Karrierës organizon takime të hapura me maturantët e gjimnazeve të interesuar për këtë program studimi. Gjithashtu Universiteti organizon dhe mer pjesë në aktivitete informuese si Open day dheëork and Study etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstaton që informimi i studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve Bachelor në “Inxhinieri Materiale” janë të aksesueshme në faqen e Universitetit. Gjithashtu Departamenti dhe Zyra e planifikimit të karrieres organizojnë takime orientuese për të informuar studentët në lidhje me: përmbajtjen e programit të studimit, për lëndët, ngarkesën mësimore, frekuentimi, syllabuset e detajuara, materialet mësimore, oraret, datat e provimeve, objektivat e kurseve, sistemin e vlerësimit etj. <i>Referencë: DVV (aneksi_033, 034)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nëpërmjet RVB dhe vizitës në Institucion GVJ u informua mbi Kurikulën dhe syllabuset e lëndëve të programit të studimeve Bachelor në “Inxhinieri Materiale”. Këto materiale u vihen në dispozicion në fillim të çdo viti studentëve të këtij programi studimi. Kjo bën që ata të jenë të mirëinformuar për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. <i>Referencë: DVV (aneksi_025)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	GVJ konstaton se përmbushja e këtij kriteri realizohet nëpërmjet aktivitetit të Zyres së Mbështetjes së Studentëve dhe Keshillimit të Karrieres. Referuar RVB, kjo zyrë i orjenton dhe i mbështet studentët për të konkuruar në tregun e punës. Gjithashtu në ueb faqen e UPT ose FIM institucioni publikon njoftime dhe mundësi për punësime, internship-e, trajnime për studentët. Informacion gjendet gjithashtu edhe në Supplementin e Diplomës “Bachelor në Inxhinieri Materiale”. Gjithashtu dhe stafi akademik i departamentit tregohet i gatshëm që ndihmojë në punësimin e studentëve, falë lidhjeve që ata kanë me sektorin industrial e privat të fushës. <i>Referencë: DVV (aneksi_055)</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët e marrin informacionin mbi zhvillimin e procesit mësimor të plotë dhe të përditësuar. GVJ konstaton se studentët i konsultojnë një pjesë të burimeve të informacionit. <i>Në takimin me ta, studentët u shprehën se hasnin probleme në lidhje me informacionin mbi bibliotekën, mungesën e aksesimit të internetit tërësisht, mungesën e ambjenteve të studimit në grup etj.</i>
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të	GVJ konstaton që informacioni në lidhje me programin e studimit bachelor në “Inxhinieri Materiale” është i plotë në Platformën “PITAGORA” e cila njihet mirë nga studentët dhe përdoret nga ta,

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al

menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	<i>Referencë: DVV (aneksi_043)</i> <i>por sërish vlen për tu përmendur mungesa e aksesimit të internetitëireless në cdo ambient të fakultetit gjë që pengon përdorimin në çdo kohë e lehtësisht prej tyre të platformes.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	GVJ konstaton se Institucioni disponon të gjithë informacionin në lidhje me studentët e regjistruar, larguar, diplomuar dhe të dhëna të tjera statistikore për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Materiale të cilat mbahen nga Sekretaria Mësimore në bazë të formateve të përcaktuara nga MAS. Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave personale të studentëve kryhet bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për këtë program studimi pasqyrohen edhe në Raportin e përvitshëm të analizës vjetore të FIM-së <i>Referencë: DVV (aneksi_030, 048, 082)</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ konstaton që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Gjatë takimit me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore GVJ i konsultoi të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. GVJ u informua që, duke filluar nga semestri i parë deri në diplomim, çdo notë e studentëve regjistrohej në kopje fizike dhe kopje elektronike në sistem duke gjeneruar informacion të qartë mbi ecurinë e studentëve dhe performancën e tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423
web site:www.ascal.al

Faqe 56

<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në takimit ne Sekretarine Mësimore GVJ konstatoi se te gjitha te dhënat lidhur me studentët e Programit Bachelor Inxhinieri Materiale ruhen në mënyrë të sigurtë në sistemin e brendshëm i cili gjeneron automatikisht të gjitha statistikatat e kërkuara nga MAS apo institucionet përkatëse. Ky sistem është funksional, i sigurtë dhe të dhënat janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p><i>Por sic është shprehur dhe me lart (Standardi III8) gjatë vizitës në sekretarinë mësimore te FIM, gjatë kontrollit të rregjistrave GVJ konstatoi se kishte shumë korigjime, si në nota ashtu edhe në të dhënat e studentëve, të bëra me korrektor, pa nje procesverbal të mbajtur nga personat përgjegjes dhe kryesekretarja.</i></p> <p><i>Për këtë arsye dhe për rëndësinë që ka rruajtja dhe dokumentimi i saktë i të dhënave, GVJ rekomandon shtimin e një rregulloreje apo procedure se cfarë ndodh në rast se bëhet një gabim njerëzor në regjistrat hard copy. Korigjimi i rregjistrave është një ndërhyrje e cila nuk duhet të ndodh pa procesverbalin përkatës.</i></p> <p><i>Gjithashtu u verejt mungesa e hedhjes së të dhënave të studentëve në rregjistrat e rinj të miratuar me udhëzimin e MAS në vitin 2019</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ konstaton se UPT dhe FIM, hartojnë në mënyrë sistematike raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_048, 082, 110)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në DVV, GVJ konstaton se UPT parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese. Statuti i UPT përcakton përfshirjen e studentëve në jetën institucionale Studentët kanë 4 përfaqësues si anëtarë të Senatit Akademik, të cilët zgjidhen me votim të vetë studentëve. Studentët përfshihen në grupin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit si dhe të vlerësimit institucional. <i>Referencë: DVV (aneksi_001)</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton që bazuar në Statutin e UPT, studentët përfaqësohen në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik në Universitet, përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Gjithashtu studentët kanë një organ të pavarur që është Këshilli Studentor, i cili promovon dhe koordinon përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_001)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri GVJ konstaton që institucioni e merr parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit kryesisht gjatë hartimit dhe përmirësimit të programit të studimit si kurikulë dhe si syllabuse.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_063, 064)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në takimin me Njësia Qëndrore të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, GVJ konstatoi se kjo njësi organizon në mënyrë periodike anketimin studentor për secilin prej programeve të studimit të ofruara në UPT si dhe për secilën lëndë/ modul të këtyre programeve. Sipas NJQSBC përfundimet e dala nga ky raport shërbejnë si objekt diskutimi dhe reflektimi për njësinë bazë dhe përfaqëson një feedback me kontributin e studentëve gjatë procesit të rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit për të cilin është kryer pyetësori. Të dhënat e këtyre raporteve gjithashtu përbëjnë një bazë të dhënash për hartimin e raporteve të analizës mësimore në nivel departamenti dhe fakulteti.</p> <p><i>Gjate takimit me studentet ata u shprehën se mendimi i tyre në shume raste nuk ishte merr në konsideratë. GVJ duke u bazuar në komentet e mesiperme rekomandon që procesi i vlerësimit të studentëve kundrejt profesoreve të ndiqet me prioritet.</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në DVV, GVJ konstaton se në përgjithësi institucioni ka mekanizmat e nevojshme për të realizuar një proces të barabartë dhe të ndershëm të vlerësimit të studentëve, si Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e cila i garanton studentit të drejtën të ankimohej, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë,</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_004)</i></p> <p><i>por nga aspekti praktik studentët shprehën pakënaqësitë e tyre në lidhje me këto procese, si përsëritjen e faktit që rivlerësimin e ankesës e bëjnë</i></p>

	<i>kolegët e profesorit të lëndës, gjë që në këndvështrimin e tyre nuk garanton rivlerësim objektiv.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ konstaton se institucioni mbështet dhe informon studentët nëpërmjet: Drejtorisë së Kurrikulave në përbërje të së cilës janë dy sektorë në shërbim të studentëve si: Sektori i Kurrikulave dhe Sektori i Procesit Mësimor. Si dhe Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit që ofron shërbimin e karrierës dhe ALUMNIT Procedurat e ndjekura prej këtyre njësive në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit. Gjithashtu edhe në FIM është ngritur dhe funksionon Zyra e Karrierës dhe Alumnas, detyra kryesore të cilës është të informojë dhe këshillojë studentët përgjatë gjithë studimeve të tyre. <i>Referencë: DVV (aneksi_025, 038, 110)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Edhe për përmbushjen e këtij kriteri GVJ mësoi që në UPT është ngritur dhe funksionon infrastruktura e posaçme organizative dhe logjistike. Universiteti ka struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve. Sekretaritetë mësimore të çdo Fakulteti, dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës shërbejnë si struktura ndihmuese për studentët. <i>Referencë: DVV (aneksi_033,034)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstatoi që në UPT, Zyra e Këshillimit të Karrierës kryen të gjitha shërbimet e këshillimit të karrierës. Duke qenë njësia që mban lidhje të vazhdueshme me kompani të ndryshme. Nga ana tjetër kjo Zyrë mirëpret studentët që ata të informohen lidhur me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Kjo zyrë i ofron studentëve këshillimin dhe orientimin e nevojshëm në lidhje me kryerjen e praktikave profesionale dhe orientimin e tyre në tregun e punës. Përpos punës së lavdërueshme të kësaj njësie, GVJ sygjeron rritjen e stafit në shërbim të Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.

Edhe për përmbushjen e këtij kriteri një rol parësor kishte Zyra e Keshillimit të Karrierës. GVJ u informua që kjo zyrë mblidhte, përpunonte dhe ruante të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve të programit Bachelor në Inxhinieri Materiale. Këto të dhëna ajo ua vinte në dispozicion si studentëve po ashtu edhe organeve e autoriteteve mbështetur në kërkesën e tyre.

Referencë: DVV (aneksi_109, 110)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konstaton se UPT në strukturën e tij, ka një njësi përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë që funksionon në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore dhe rregulloret e brendshme të institucionit. Ngritja dhe funksionet e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë janë të bazuara respektivisht në Statutin e institucionit, Neni 80 Sigurimi i Cilësisë.</p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi_001)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në takimin me anetarët e Njësisë Qendrore të Sigurimit të Cilësisë dhe Njësitë të Sigurimit të Cilësisë, pasi Rrjeti i Cilësisë në UPT përbëhet nga Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC), e ngritur në rektorat dhe Njësitë të Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore, GVJ konstaton se kjo është një njësi e përhershme e pavarur, e angazhuar në menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>Bazuar në DVV dhe nga takimi me përfaqësuesit e kësaj njësie, GVJ nuk ka arritur në ndonjë informacion në lidhje me rregulloren e funksionimit të kësaj njësie. GVJ rekomandon përfshirjen me të madhe të studenteve në procesin e formulimit të pyetjeve dhe përpunimit të rezultateve. Kjo do të rriste besimin në procesin e vlerësimit nga ana e studenteve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UPT përdor Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative si dhe metodologji dhe instrumenta për matjen e cilësisë së proceseve akademike. Institucioni i nështrohet proceseve të Akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit. Studentët janë gjithashtu të përfshirë në përgatitjen e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm të përgatitur në kuadër të akreditimit të institucionit dhe programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang</p>	<p><i>Bazuar në DVV dhe nga takimi me përfaqësuesit e kësaj njësie GVJ nuk ka arritur në ndonjë informacion në lidhje me rregulloren e funksionimit.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 61

institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	GVJ konstaton se Departamenti është njësi bazë përgjegjëse për mirë funksionimin e programit të studimit dhe për të siguruar cilësinë e saj. Monitorimi dhe rishikimi i programeve të studimit kryhet nga departamentet përkatëse, i cili më pas kalon në filtrin e Drejtorisë së kurrikulave dhe miratimin final e mer nga Senati Akademik. <i>Referencë: DVV (aneksi_004)</i>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Institucioni posedon mekanizma formale për monitorimin e programeve të studimit si Drejtoria e Kurrikulave, Këshillat e Fakulteteve, Senati Akademik, Rektorati etj. Me anë të këtyre mekanizmave institucioni kryen mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Procedurat e kontrollit të cilësisë janë të formalizuara në rregulloren përkatëse. <i>Referencë: DVV (aneksi_004, 044)</i> <i>Megjithëse Institucioni i ka të ngritura të gjitha mekanizmat e nevojshme për përmirësimin e programeve, referuar DVV dhe takimeve në institucion për programin e studimit Inxhinieri Materiale nuk është bërë asnjë ndryshim kurrikule që me hapjen e këtij programi në vitin 2005.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	GVJ konstaton se UPT posedon metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj, <i>por duke u bazuar dhe në faktin që programi nuk ka bërë asnjë përmirësim që nga viti i themelimit në 2005 lë hapësirë për dyshime në implementimin e këtyre metodologjive. Referencë: DVV (aneksi_RVB)</i>
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Institucioni nëpërmjet NJQSC dokumenton Raportet e Vlerësimit të brendshëm në mënyrë që të monitorojë ecurinë e programeve në vazhdimësi. Kjo njësi vendos raportete e vlerësimit në dispozicion të departamentit, fakultetit, rektoratit dhe senatit akademik si organe vendimmarrëse të institucionit.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al

Faqe 62


<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në takimin me anëtarët e NJBSC, GVJ konstatoi se kjo njësi përgatit një raport periodik të vlerësimit të cilësisë dhe ia paraqet në formë zyrtare Rektoratit dhe Senatit Akademik. Bazuar në informacionin e pasqyruar në këtë raport institucioni merr masat e nevojshme për adresimin e mangësive të konstatuara dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. <i>Referencë: DVV (aneksi_001, 063, 065, 082)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>GVJ konstaton se NJQSC kryen në mënyrë periodike Vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit. Ky raport përfshihet nga Institucioni në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. <i>Referencë: DVV (aneksi_082)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit, institucioni me anë të NJQSC përpilon raportin e analizës së pyetësorëve i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Të dhënat e këtij raporti i shërbejnë institucionit si një instrument për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore. <i>Referencë: DVV (aneksi_065)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të</p>	<p>Bazuar në DVV, UPT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit kryen analizë mësimore në fund të çdo viti akademik në nivel stafi, departamenti dhe fakulteti. Përgjegjësi i Departamentit në fillim të vitit akademik në bashkëpunim me stafin akademik kontrollon dhe vlerëson përmbajtjen e syllabuseve, por aprovohen nga titullari i lëndës. Përgjegjësi i Departamentit realizon vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së leksioneve/ seminareve etj, praktikë që verifikon kryerjen e procesit të mësimdhënies nga pikpamja sasiore (Orët leksion, seminare, laboratore)</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al



<p>standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>Përgjegjësi i Departamentit nuk disponon asnjë praktikë ligjore të miratuar nga Senati për grumbullim të dhënash cilësore.</i></p> <p><i>Referencë: DVV (aneksi 001, 006)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Krahas metodave të mesipërme të drejtpërdrejta institucioni përdor dhe metoda të tërthorta. Ky bejnë pjesë takime me studentët dhe marrja e mendimeve të tyre në lidhje me çështje specifike apo të mbarëvajtjes të përgjithshme, pjesëmarrje në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studentëve, punësimin, opinionet e tyre mbi rezultatet e të nxëniet dhe orientimit në tregun e punës, takime me të diplomuar etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV, UPT parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në Statutin dhe rregulloret e UPT parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Njëkohësisht në këto dokumente përcaktohen dhe përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>Referencë: DVV (aneksi 001, 002, 006)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni është i angazhuar për të garantuar integritetin akademik dhe barazinë kundrejt personelit dhe studentëve.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al

<p>njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>UPT vlerëson, garanton dhe siguron e cilësinë në përputhje me integritetin akademik duke shmangur cdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me drejtuesit dhe me stafin e programit të studimit GVJ konstatoi se Departamenti, si njësi bazë, është përgjegjëse për mirë funksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Konstatohet se përgjegjësi i programit të studimit, personeli akademik e administrative, si dhe studentët e programit të studimit (me anë të pyetsorit të organizuar nga NJSBC) janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë. <i>Referencë: DVV (aneksi_065)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar ne DVV dhe në vizitën në Institucion GVJ konstaton se UPT përdor instrumenta të drejtpërdrejta dhe të tërthorta me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit duke respektuar lirinë dhe etiken akademike si dhe ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. <i>Por sic cilësohet dhe në RVB në FIM nuk ka një praktikë ankimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ në shërbim të tyre për diskriminim dhe pabarazi.</i> <i>Gjithashtu gjatë takimit me ta studentët u shprehën se ndejne njëfarë presioni nga ana e disa pedagogeve dhe ka raste që janë të detyruar të blejnë librat e tyre, në të kundërt nuk lejohen të ndjekin mësimin.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Bazuar në RVB “departamentet e FIM nuk kanë një strukturë të konsoliduar të vlerësimit të cilësisë që operon me të njëjtat metodologji dhe instrumenta si NJSBC/NJQSC-së. <i>Nuk ekziston një praktikë periodike vjetore e marrjes së feedback-ut nga ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, duke përfshirë biznesmenë, institucione publike dhe private ku të diplomuarit e një programi studimi janë punësuar.”</i> Departamenti është munduar të përfitojë nga ekspertiza e ekspertëve të jashtëm në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën. nëpërmjet angazhimit të tyre në mësimdhënie, por edhe në takime të ndryshme, në leksione të hapura,workshope etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar ne RVB UPT, i bën transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit, nëpërmjet postimit në faqen zyrtare elektronike (http://upt.al/) të Universitetit (Statuti, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, Raportet e analizës së rezultateve të pyetësorëve të anketimit të studentëve, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj) si dhe nëpërmjet shkresave zyrtare tek të gjitha Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë duke krijuar kështu një universitet të hapur e transparent me të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij. <i>Referencë: DVV (aneksi_001, 065)</i>
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Bazuar ne DVV dhe në vizitën në Institucion GVJ konstaton se UPT përdor instrumenta të drejtpërdrejta dhe të tërthorta me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Bazuar ne RVB dhe nga takimi me NJQSC, GVJ u informua se rezultatet e pyetësorit për çdo pedagog i përcillen Rektorit së bashku me një analizë statistikore mbi indikatorët. Bazuar në këto rezultate hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. Këto analiza përmbledhen në trajtë raporti dhe i përcillen njësisve kryesore dhe atyre bazë për të zhvilluar analiza të mëtejshme e për të vijuar punën mbi përmirësimin e cilësisë. Raportet janë publike dhe të aksesueshme online. <i>Referencë: DVV (aneksi_065)</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Politikat dhe Procedurat e Sigurimit të Cilësisë janë zyrtarisht të miratuara, të dokumentuara dhe janë rishikuar dhe zhvilluar si përgjigje ndaj ndryshimeve kombëtare dhe ndërkombëtare me synim përmirësimin e vazhdueshëm. <i>Referencë: DVV (aneksi_048, 065, 082)</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe	Institucioni, në bashkëpunim me fakultetet, nëpërmjet Specialisit të Karrieres organizon seanca informimi për studentët në lidhje me ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.

përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<i>Referencë: DVV (aneksi_109)</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Niveli i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Niveli i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423
web site: www.ascal.al

Faqe 67


Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Materiale” i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Inxhinieri Materiale është pjesë e një IAL solid dhe me shumë experiencë si FIM/UPT.
2. Programi i studimit Inxhinieri Materiale pranë FIM/ UPT është pjesë unik në Shqipëri gjë që favorizon përthithjen e studentëve që duan të specializohen në këtë fushë.
3. Programi i studimit Inxhinieri Materiale pranë FIM/UPT funksionon në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, dhe është në përputhje me kartën e Bolonjës gjë që rrit mundësitë e realizimit të mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik dhe lehtëson kushtet e njohjes së diplomave në vendet e Bashkimit Europian.
4. Duke qënë një program inxhinierik aplikativ i mundëson studentëve praktikimin në sektore të ndryshme të industrisë.
5. Pjesëmarrja në projekte të ndryshme në bashkëpunim me IAL kombëtare dhe ndërkombëtare.
6. Ambientet bashkëkohore të zhvillimit të procesit mësimor, salla leksione, seminare të bollshme dhe të pajisura me pajisje logjistike të nevojshme.
7. Laboratorë të dedikuar për kurrikulën e programit të studimit me instrumentët/aparaturat si dhe paketa softare specifike për disa nga programet mësimore.
8. Bashkëpunimi me kompani që operojnë në tregun e Inxhinierisë së Materialeve.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e një raporti të dedikuar analitik për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit. **(Standardi I.5, kriteri 3)**
2. Mungesa e përdorimit të metodave inovative në mësimdhënie në disa prej lëndëve të zhvilluara. **(Standardi III.1, kriteri 1)**
3. Vlerësimi i stafit nga studentët. Shpesh herë studentët nuk ndihen konfort të shprehin mendimin e tyre. **(Standardi III.1, kriteri 2)**
4. Mungesa e ushtrimit të të drejtës për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi nga ana e studentëve **(Standardi III.6, kriteri 8)**
5. Dokumentimi jo korrekt i rezultateve në regjistrat fizik të programit të studimit. Vihen re mangësi dhe pasaktësi në punën e sekretarisë. **(Standardi III.8, kriteri 10)**
6. Mungesa e përmirësimit dhe modernizimit të kurrikulës së programit që nga hapja e programit. **(Standardi VI.2, kriteri 2)**
7. Mungesa e aksesimit të rretit WIFI në amjentet e Fakultetit. **(Standardi V.3, kriteri 4 dhe 5)**




8. Mungesa e informacionit tek studentët në lidhje me materialet studimore në Bibliotekat e institucionit. Gjithashtu mungesa e kompjuterave fizike në bibliotekë për aksesimin e materialeve. (Standardi IV.4, kriteri 4 dhe 6)

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që institucioni çdo fund viti të hartojë një raport për përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Materiale".
2. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se praktikat profesionale të studentëve paraqesin mangësi, kjo pjesërisht e justifikuar nga situata e jashtëzakonshme për shkak të pandemisë. Rekomandohet ti kushtohet më shumë vëmendje praktikës profesionale si një element kyç në formimin profesional të studentëve.
3. Rekomandohet që lëndet me zgjedhje të jenë vertetë të tilla dhe jo të paracaktuara. (Metalurgji e metaleve me ngjyra dhe Materiale Qeramike Tradicionale)
4. GVJ rekomandon që metodat inovative të mësimdhënies të masivizohen në të gjitha lëndët e programit të studimit.
5. GVJ rekomandon ti kushtohet më shumë vëmendje procesit të mbledhjes së informacionit nga studentët dhe të nxiten ata të shprehin mendimin e tyre lirshëm. Gjithashtu GVJ rekomandon që rezultatet të shpërndahen në mënyrë individuale tek secili profesor për secilën lëndë në mënyrë që stafi akademik të ketë një informacion të plotë për secilën lëndë që ai/ajo ligjeron. Gjate takimit me studentet ata u shprehën se mendimi i tyre në shumë raste nuk ishte marrë në konsideratë. GVJ duke u bazuar në komentet e mësipërme rekomandon që procesi i vlerësimit të studentëve kundrejt profesorëve të ndiqet me prioritet. GVJ rekomandon përfshirjen më të madhe të studentëve në procesin e formulimit të pyetjeve dhe përpunimit të rezultateve. Kjo do të rriste besimin në procesin e vlerësimit nga ana e studentëve.
6. GVJ Rekomandon që të rishikohet procedura e ankimit të notave dhe të nxiten studentët të shprehin lirshëm ankesat e tyre.
7. GVJ gjatë vizitës në UPT dhe në sekretarinë mësimore, specifikisht gjatë kontrollit të rregjistrave, u vu re që kishte shumë korigjime, si në nota ashtu edhe në të dhënat e studentëve. Për këto korigjime, të bëra me korrektor, nuk kishte asnjë procesverbal të mbajtur nga personat përgjegjës dhe kryesekretarja. Për këtë arsye dhe për rëndësinë që ka ruajtja dhe dokumentimi i saktë i të dhënave, GVJ rekomandon shtimin e një rregulloreje apo procedure se çfarë ndodh në rast se bëhet një gabim njerëzor në regjistrat hard copy. Korigjimi i rregjistrave është një ndërhyrje e cila nuk duhet të ndodh pa procesverbalin përkatës.
8. GVJ rekomandon shtimin e kompjuterave fizik në bibliotekë.
9. GVJ rekomandon shtimin e hapsirave punuese për studentët si dhe shërbimin WIFI në të gjitha hapsirat e IAL.
10. Megjithatë Institucioni i ka të ngritura të gjitha mekanizmat e nevojshme për përmirësimin e programeve, referuar DVV dhe takimeve në institucion për programin e studimit Inxhinieri Materiale nuk është bërë asnjë ndryshim kurrikule që me hapjen

e këtij programi në vitin 2005. GVJ rekomandon përditësimin e kurrikulave për të ndjekur ritmet e kohës.

A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a checkmark at the end, located at the bottom right of the page.


Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Materials Engineering" of the Higher Education Institution "Polytechnic University of Tirana"

Strengths and Affirmations:

1. The Materials Engineering study program is part of a solid and experienced HEI such as FIM/UPT.
2. The Materials Engineering study program at FIM/UPT is a unique part in Albania, which favors the absorption of students who want to specialize in this field.
3. The Materials Engineering study program at FIM/UPT operates in accordance with the Law on Higher Education, and is in accordance with the Bologna Charter, which increases the possibilities of realizing the mobility of students and academic staff and facilitates the conditions for the recognition of diplomas in the countries of European Union.
4. Being an applied engineering program, it enables students to practice in different sectors of the industry.
5. Participation in various projects in cooperation with national and international HEIs.
6. Contemporary premises for the development of the learning process, lecture halls, ample seminars and equipped with the necessary logistical equipment.
7. Laboratories dedicated to the study program curriculum with instruments/apparatus as well as specific software packages for some of the teaching programs.
8. Cooperation with companies operating in the Materials Engineering market.

Weak points:


1. Lack of a dedicated analytical report on the benefit from cooperation agreements. **(Standardi I.5, criteria 3)**
2. Lack of use of innovative teaching methods in some of the developed subjects. **(Standard III.1, criterion 1)**
3. Evaluation of staff by students. Often times students do not feel comfortable expressing their opinion. **(Standard III.1, criterion 2)**
4. Lack of exercise of the right to contest the result of an assessment by students **(Standard III.6, criterion 8)**
5. Incorrect documentation of results in physical records of the study program. Deficiencies and inaccuracies in the work of the records office are noted **(Standard III.8, criterion 10)**
6. Lack of improvement and modernization of the program's curriculum since the program's inception. **(Standardi VI.2, criteria 2)**
7. Lack of access to the WIFI network in the Faculty's premises. **(Standard V.3, criteria 4 and 5)**




8. Lack of information among students regarding study materials in the institution's Libraries. Also, the lack of physical computers in the library for accessing materials. **(Standard IV.4, criteria 4 and 6)**

Recommendations:

1. EEG (External Evaluation Group) recommends that the institution prepare a report at the end of each year on the benefits of cooperation agreements in order to realize the Bachelor's study program in "Materials Engineering".
2. EEG found during the visit to the institution that the professional practices of the students present deficiencies, this is partially justified by the extraordinary situation due to the pandemic. It is recommended to pay more attention to professional practice as a key element in the professional training of students.
3. It is recommended that the optional subjects are truly such and not predetermined. (Metallurgy of non-ferrous metals and Traditional Ceramic Materials)
4. EEG recommends that innovative teaching methods be massified in all subjects of the study program.
5. EEG recommends paying more attention to the process of gathering information from students and encouraging them to express their opinion freely. Also EEG recommends that the results be distributed individually to each professor for each subject so that the academic staff has complete information for each subject he/she teaches. During the meeting with the students, they expressed that their opinion was not taken into consideration in many cases. EEG based on the above comments recommends that the process of evaluating students against professors be followed with priority. EEG recommends greater involvement of students in the process of formulating questions and processing results. This would increase students' confidence in the assessment process.
6. EEG Recommends that the grade appeal procedure be revised and students be encouraged to express their complaints freely.
7. During the visit to UPT and the teaching secretariat, specifically during the control of the registers, it was noticed that there were many corrections, both in the grades and in the data of the students. For these corrections, made with a proofreader, there was no record kept by the responsible persons and the chief secretary. For this reason and for the importance of accurate data storage and documentation, EEG recommends the addition of a regulation or procedure on what happens if a human error is made in the hard copy records. Correcting the records is an intervention that should not happen without the relevant minutes.
8. EEG recommends adding physical computers to the library.
9. EEG recommends the addition of workspaces for students as well as WIFI service in all HEI spaces.
10. Although the Institution has set up all the necessary mechanisms for improving the programs, referring to the Self Evaluation Folder and the meetings in the institution for the Materials Engineering study program, no curriculum change has been made since



the opening of this program in 2005. EEG recommends updating the curricula to follow the rhythms of time.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/ EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	